

RELACION MBI BUXHETIN E VITIT 2021

DHJETOR 2020



BASHKIA KORÇË

Përmbajtja e buxhetit vjetor 2021

Hyrje	
1. Kuadri ligjor.....	7
2. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore	8
3. Objektivat e buxhetit vendor.....	8
4. Buxhetimi gjinor	9
5. Të ardhurat e veta të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore	9
5.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.....	9
5.2. Të ardhurat nga institucionet e vartësisë.....	28
6. Transfertat nga buxheti i shtetit	28
6.1. Transferta e pakushtëzuar	28
6.2. Transfertat e pakushtëzuara sektoriale.....	29
6.3. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	30
6.4. Transferta specifike.....	30
7. Buxheti 2021	31
7.1. Dokumentacioni bazë:	34
7.2. Dokumentacioni shoqërues	37
8. Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2021	41
8.1. Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110.....	42
8.2. Programi: Çështjet Financiare dhe Fiskale 01120	44
8.3. Programi: Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm 01710.....	45
8.4. Programi: Shërbimet e Policisë Vendore 03140	45
8.5. Programi: Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile 03280	46
8.6. Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik 04130.....	47
8.7. Programi: Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve 04220	47
8.8. Programi: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave 04260.....	48
8.9. Programi: Rrjeti Rrugor Rural 04520	49
8.10. Programi: Transporti Publik 04570	49
8.11. Programi: Zhvillimi i Turizmit 04760	51
8.12. Fondi rezervë 04910	68
8.13. Fondi i kontigjencës 04940.....	68
8.14. Programi: Menaxhimi i Mbetjeve 05100.....	68
8.15. Programi: Ndërgjegjësimi Mjedisor 05630	69



BASHKIA KORÇË

8.16.Programi: Planifikimi Urban Vendor 06140.....	70
8.17.Programi: Shërbime Publike Vendore 06260	70
8.18.Programi: Ndriçim Rrugësh 06440	71
8.19.Programi: Sport dhe Argëtim 08130.....	72
8.20.Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor 09120	74
8.21.Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 09230	75
8.22.Programi: Sigurimi Shoqëror 10220	76
8.23. Programi: Kujdesi Social për Personat e Sëmurë dhe me Aftësi të Kufizuara 10140	78
8.24.Programi: Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët 10430.....	79
8.25.Programi: Strehimi Social 10661	86
9.Buxheti për institucionet e varësisë	95
9.1.Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	95
9.1.1.Programi: Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 04240	96
9.1.2. Programi: Rrjeti rrugor rural 04520	97
9.1.3.Programi: Shërbime publike vendore 06260	97
9.1.4. Programi: Ndriçim rrugësh 06440	100
9.2.Klubi Shumësportësh.....	101
9.2.1.Programi: Sport dhe argëtim 08130.....	101
9.3. Qendra e Artit dhe Kulturës	103
9.3.1. Programi: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 08220	103
9.4.Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdhes	108
9.4.1.Programi: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor 09120	108
9.4.2Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 09230	114
9.4.3. Programi: Arsimi profesional 09230	116
9.4.4.Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430	117
9.5.Qendra Ditore dhe Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	119
9.5.1 Programi:Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara 10140	119
9.6.Shtëpia e Foshnjës.....	121
9.6.1.Programi: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 10430	121
9.7.Njësia e Menxhimit të Banesave me Qëllim Social.....	122
9.7.1.Programi: Strehimi social 10661	122
10. Të tjera	124
10.1.Tabela e detajuar e investimeve 2021 sipas institucioneve	124



BASHKIA KORÇË

Lista e tabelave

Tabela 1: Të ardhurat e institucioneve	28
Tabela 2: Tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme	28
Tabela 3: Tranferta e pakushtëzuar e sektoriale	29
Tabela 4: Burimet e financimit	31
Tabela 5: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike.....	32
Tabela 6: Fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese	34
Tabela 7: Përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve	35
Tabela 8: Numri i punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore	36
Tabela 9: Llogaritja e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore.....	37
Tabela 10: Përmbledhje e të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë	41

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme.....	29
Grafiku 2: Tranferta e pakushtëzuar sektoriale.....	30
Grafiku 3: Burimet e financimit (PI 2019, 2020, PI i rish 2020, PI 2021)	31



BASHKIA KORÇË

Hyrje

Hartimi i buxhetit për vitin 2021 ka qënë një sfidë për Bashkinë Korçë si për çdo bashki në vend. Në kushtet e pandemisë Covid 19 që ka paralizuar në gjithë botën ekonominë, bizneset dhe ekonomine familjare planifikimi buxhetor është orjentuar në respektim të plotë të kushteve të reja të krijuara.

Nisur nga kjo panoramë që duket të jetë e njëjtë në të gjithë vëndin ne jemi përpjekur të planifikojmë një buxhet ku pavarësisht të ardhurave të reduktuara e nevojave të reja të paraqitura përballë nesh në këto kushte, banorëve të territorit të bashkisë, në qytet e fshatra të mos iu mungojnë shërbimet, kujdesi social aq i domosdoshëm në këtë periudhë si edhe investimet e domosdoshme.

Korça prej vitesh ka hyrë në një rrugë të konsoliduar të zhvillimit të saj dhe pavarësisht kushteve të reja Bashkia Korçë do të bëjë më të mirën edhe këtë vit për banorët e territorit të saj në qytet dhe fshatra.

Në planifikimin buxhetor, bashkia ka prioritarizuar shërbimet dhe kujdesin social pa lënë mënjanë përmirësimin e infrastrukturës, duke rivitalizuar dhe kthyer në identitet, vlera të çmuara të trashëgimisë urbane, që e dallojnë Korçën nga pjesët e tjera të Shqipërisë, si edhe duke krijuar vlera të reja të cilat i kanë dhënë Korçës një dimension të ri.

Në kushtet e shtimit të vështirësive ekonomike për familje e biznese, bashkia ka orjentuar buxhetin e saj në shërbime ndaj komunitetit, shtresave në nevojë, çerdhe, kopshte, shkolla, qendra për moshën e tretë, duke i qëndruar kështu më pranë nevojave të banorëve.

Veç ndërhyrjeve në infrastrukturë në vëmendjen tonë këtë vit do të jetë edhe sektori i teknologjive të informacionit. Një program i plotë tashmë i hartuar, si edhe rrjeti i ngritur i partnerëve që do të na ndihmojnë në këtë drejtim, do të mundësojnë trajnime dhe mundësi punësimi për të rinjtë në fushën e teknologjive të informacionit duke e bërë Korçën një qëndër të rëndësishme në Shqipëri në këtë drejtim.

Zhvillimi i turizmit në këto vite ka qënë dhe vijon të jetë një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për Korçën kështu që do të vijojë të jetë në vëmendjen tonë edhe për vitin 2021.

Numri gjithnjë në rritje i vizitorëve ka shtuar jo vetëm numrin e bizneseve të shërbimit turistik dhe të ardhurat për ofruesit e këtyre shërbimeve, por ka imponuar edhe nevojën e orjentimit të një pjesë të rëndësishme të buxhetit të bashkisë në drejtim të mbështetjes për turizmin.

Kemi planifikuar një paketë eventesh më të reduktuar në krahasim me vitet e tjera në qytet dhe fshatra, të shtrirë në të gjithë muajt e vitit, një kalendar të pasur me aktivitete kulturore e sportive jo vetëm lokale, por edhe kombëtare e ndërkombëtare, kanë për qëllim jo vetëm ruajtjen dhe promovimin e vlerave më të mira të traditës, por sidomos promovimin e Korçës si një nga qendrat më të rëndësishme kulturore e turistike në Shqipëri. Gjithmonë duke shpresuar në përmirësimin e kushteve të shkaktuara nga pandemia për realizimin e plotë të tyre.

Me administrimin efektiv të buxhetit të saj si edhe me mbështetjen e qeverisë dhe donatorëve, Bashkia Korçë edhe gjatë vitit 2021 do të zbatojë programe e projekte të rëndësishme zhvillimi, pjesë e vizionit të saj strategjik për zhvillimin e Korçës dhe përmirësimin e jetesës së banorëve në qytet dhe fshatra.



BASHKIA KORÇË

Veçori gjeografike të territorit të bashkisë.

Bashkia Korçë ndodhet në qarkun e Korçës, në pjesën juglindore të Shqipërisë, në një sipërfaqe prej 805.99 km², me shtrirje veri-jug 30 km dhe lindje –perëndim 53 km.

Në veri kufizohet me bashkinë e Maliqit, në lindje me bashkinë e Devollit, në jug me bashkinë e Kolonjës, Përmetit dhe në perëndim me bashkinë e Skraparit. Vendodhja gjeografike ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e territorit. Nëpërmjet rrjetit rrugor Korça dhe rrethinat lidhen me kryeqendrën e vendit, Tiranën në veri dhe qendrën e jugut Gjirokastrën. Në të njëjtën kohë pozita gjeostrategjike, në një zonë ndërkuftare me Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut, ka bërë që në të, të kalojnë akse të rëndësishme të komunikacionit që lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë. Qyteti i Korçës është qendra më e rëndësishme e qarkut dhe njëkohësisht një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike dhe kulturore në Shqipëri.

Në aspektin fiziko-gjeografik territori i bashkisë përfshin disa njësi fiziko gjeografike si: shpatin perëndimor të malit të Moravës, pjesën jugore të fushëgropës së Korçës, malësinë e Voskopojës dhe malësinë e Vithkuqit. Lartësia e relievit shkon nga 500 m (përroi i Panaritit) në 2383 m (Mali i Ostrovicës), ku amplituda hipsometrike është 1883 m.

Klima dallohet për tipare mesdhetare, paramalore dhe malore me një ndikim të klimës kontinentale, sidomos gjatë periudhës së ftohtë të vitit.


Territori i bashkisë bën pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumit Devoll dhe lumit Osum, ku një nga degët më të rëndësishme ujore është Dunavecii. Përbërja e tokave është e ndryshme dhe variojnë nga brezi i tokave të kafenjta, të murrme pyjore dhe livadhore malore.

Në aspektin administrativ bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative si Korçë, Drenovë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq dhe Mollaj, në të cilat bëjnë pjesë një qendër urbane/qytet dhe 62 vendbanime rurale/fshatra. Popullsia e bashkisë është 129.065 banorë. Zhvillimi ekonomik bazohet tek disa sektorë të zhvilluar siç është bujqësia dhe blegtoria në zonat rurale, tregtia, ndërtimi, sektori agropërpunues, tekstilet dhe turizmi. Përmirësimet në infrastrukturë kanë lehtësuar jo vetëm përdorimin e burimeve natyrore por kanë nxitur zhvillimin e turizmit në zonat malore me interes të veçantë.

Vlen për t'u theksuar se turizmi është një ndër sektorët ekonomik, që po zhvillohet me ritme të shpejta. Qyteti i Korçës si edhe fshatrat përreth, Voskopoja, Dardha, Vithkuqi, Boboshtica dhe të tjera, ofrojnë pasuri të shumta kulturore dhe natyrore, që po rrisin gjithnjë e më shumë praninë e vizitorëve vendas dhe të huaj. E përcaktuar tashmë si destinacion turistik në zhvillim, bashkia Korçë ofron mundësi dhe sfida drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm, çka do të ndikojë në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e jetës së komunitetit në territorin e saj.



BASHKIA KORÇË



Projekt buxheti i vitit 2021 synon përmirësimin e situatës ekonomike, e cila për shkak të pandemisë Covid-19 pësoi rënie. Ky projekt buxhet bazohet tek ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Projekt Buxheti 2021 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra nga qeveria, që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin si dhe masat parandaluese të përhapjes së Covid-19.

1. Kuadri ligjor

- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9869/2008 “Për huamartjen e qeverisjes vendore;
- Udhëzimi nr. 2 datë 06.02.2012 i Ministrisë së Financave “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar



BASHKIA KORÇË

- Ligje dhe akte nënligjore të tjera.

2. Parimet themelore të financave të vetëqeverisjes vendore

1. Politikat kombëtare financiare garantojnë mjaftueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe bazohen në parimin e shumëllojshmërisë së burimeve të të ardhurave.
2. Funkcionet dhe kompetencat që u delegohen njësive të vetëqeverisjes vendore shoqërohen kurdoherë me mjetet e nevojshme financiare për realizimin e tyre.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj.
4. Njësive të vetëqeverisjes vendore u garantoher me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.
5. Në rast se ndryshimet në politikën fiskale shoqërohen me ulje të niveleve, normave dhe bazës së taksave vendore apo të pjesës së të ardhurave të njësive të qeverisjes vendore nga taksat e ndara, Ministria e Financave është e detyruar të marrë masat për kompensimin e uljes, nëpërmjet rritjes së transfertave financiare dhe mundësive për huamarrjen vendore dhe/ose formave të tjera.
6. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore harton, miraton, zbaton dhe administron çdo vit buxhetin e vet, pa deficit, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon administrimin e zbatimin e sistemit buxhetor dhe ligjin për financat vendore.

3. Objektivat e buxhetit vendor

- Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjitha etapat që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij.
- Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve administrative me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me kosto sa më të ulët.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar.
- Përmirësimi i cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor, nëpërmjet përmirësimit të raportimit dhe analizës financiare vendore dhe krijimit të një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.
- Sigurimi i menaxhimit financiar transparent dhe efektiv për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.



BASHKIA KORÇË

- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit (buxhetimi me pjesëmarrje).

Gjithashtu, përmes buxhetit të vitit 2021, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim konsolidimin e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve.

4. Buxhetimi gjinor

Gjatë planifikimit të buxhetit 2021 është pasur parasysh që ky buxhet të sigurojë:

- marrjen në konsideratë të nevojave të ndryshme të grave dhe burrave.
- që kontribuon në zvogëlimin e pabarazisë gjinore
- planifikimin e projekteve me fokus gratë, fëmijët dhe të moshuarit

5. Të ardhurat e veta të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore

Njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

5.1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë të drejtë të administrojnë taksat vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.
2. Taksat vendore mund të klasifikohen sipas kategorive të mëposhtme:
 - a. taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to;
 - b. taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja;
 - c. taksa vendore mbi veprimtarinë e shërbimit hotelier;
 - d. taksa e tabelës;
 - e. taksa vendore të përkohshme, të cilat vendosen sipas mënyrës së parashikuar në ligj;
 - f. taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të biznesit të vogël;
 - g. taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimitë, testamentet ose lotaritë vendore;
 - h. taksa të tjera, të përcaktuara me ligj.
 - i. tarifa për zënie dhe përdorimin e hapësirës publike dhe të fasadave



BASHKIA KORÇË

- j. tarifa e pastrimit
- k. tarifa e ndriçimit
- l. Tarifa e gjelbërimit
- m. tarifa për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit
- n. tarifa për shërbimet administrative dhe dhënie e licencave, lejeve e autorizimeve
- o. tarifa të tjera, të përcaktuara nga këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021 për Bashkinë Korçë është mbështetur kryesisht:

- Në nivelet e taksave dhe tarifave vendore të miratuara në legjislacionin tatimor aktual në fuqi si dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkisë Korçë
- Në realizimin faktik të të ardhurave për vitin 2020 dhe pritshmërinë deri në fund të vitit.
- Në përllogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve.
- Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitore, referuar legjislacionit në fuqi.
- Në parashikimin e të ardhurave që mblidhen nga agjentët tatimore.
- Në parashikimin i të ardhurave që mblidhen nga drejtoritë dhe institucionet e Bashkisë.
- Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëttimeve.
- Në forcimin e kapaciteteve administruese.
- Në lehtësimi i procedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

Drejtoritë e Bashkisë, institucionet dhe agjentët tatimore janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë Korçë.

Në mënyrë të detajuar po paraqesim realizimin e vitit 2019, planifikimin e vitit 2020, realizimin 11 - mujor të vitit 2020, realizimin e pritshëm për vitin 2020 si dhe planifikimin për vitin 2021 në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë e Korçës.

Lloji i taksës ose tarifës	Realizim 2019	Plani 2020	Realiz.11 muaj 2020	Plani i pritshëm 2020	Plani 2021
Taksë mbi ndërtesën	96,209,399.22	153,306,758.00	83,001,593.38	91,074,524.38	205,372,855.00
Taksë mbi truallin	8,109,107.00	13,020,875.00	7,717,172.00	8,131,745.00	20,967,766.00
Taksë mbi tokën bujqësore	17,871,800.90	54,066,337.00	13,647,465.00	17,554,042.00	50,984,382.00
Tatim shitjeje pasuri e paluajtshme	9,161,810.37	15,000,000.00	2,461,950.02	3,053,456.02	11,000,000.00
Taksë rregjistrimi e përvitshme (automjete)	41,140,294.00	43,000,000.00	34,652,660.00	38,623,152.00	43,000,000.00



BASHKIA KORÇË

Tatim fitimi i thjeshtuar për biznesin e vogël	5,555,847.66	18,000,000.00	5,094,419.00	5,251,827.00	6,876,731.00
Taksë për ndërtimet e reja	87,219,242.00	154,111,840.00	42,305,723.00	52,767,130.00	58,000,000.00
Taksë ndikimi në infrastrukturë nga legalizimet	13,435,258.00	43,000,000.00	4,372,332.00	4,921,475.00	23,873,515.00
Taksë fjetje në hotel	5,754,310.00	4,000,000.00	3,572,074.00	4,196,754.00	5,000,000.00
Taksë tabelle	8,140,330.30	17,000,000.00	7,347,220.00	7,420,958.00	7,429,050.00
Dividenti nga UKKO	15,515,582.00	9,000,000.00	661,319.00	661,319.00	5,000,000.00
Renta minerare	575,607.00	350,000.00	395,906.00	395,906.00	200,000.00
Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,605,680.00	1,000,000.00	855,670.00	1,084,520.00	910,000.00
Tarifë therje bagëti	2,175,500.00	4,000,000.00	1,018,998.00	1,185,898.00	1,446,733.00
Tarifë mur perimetral	1,092,020.00	800,000.00	619,340.00	730,960.00	650,000.00
Tarifë pastrimi	158,711,064.88	193,702,655.00	136,975,157.93	146,416,166.00	195,879,182.00
Tarifë ndriçimi	35,295,758.17	46,509,432.00	30,310,133.17	32,226,384.17	45,261,479.00
Tarifë gjelbërimi	23,404,849.37	29,304,445.00	20,151,030.95	21,230,975.95	28,784,320.00
Tarifë mirëmbajtje varreza publike	12,948,926.00	17,551,850.00	10,783,763.00	12,042,677.00	17,654,037.00
Tarifë zënie hapësire publike	21,024,032.00	22,774,290.88	11,703,889.00	14,031,439.00	25,913,941.00
Tarifë parkimi	18,707,966.00	19,252,500.00	12,432,088.00	14,423,644.00	20,839,207.00
Të ardhura të tjera	11,362,845.00	25,996,477.00	35,122,564.00	36,273,780.00	13,229,337.00
Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	1,517,600.00	130,000.00	338,000.00	1,768,100.00	260,000.00
Miratim projekti	562,450.00	220,000.00	365,500.00	415,200.00	200,000.00
Shërbime zjarrfikse në objekte të siguruar.	0	50,000.00	0	0	30,000.00
Shërbime zjarrfikse ndaj te treteve	0	0	0	0	50,000.00
Marrje me qera pylli+ qera per kullota	13,941,945.50	9,000,000.00	5,667,156.19	8,323,240.19	10,000,000.00
Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit	12,540,960.00	3,000,000.00	2,709,640.00	6,009,640.00	2,500,000.00
Vërtetime transporti	78,000.00	40,000.00	66,000.00	81,000.00	40,000.00
Prodhimet e dyta medicinale	663,000.00	600,000.00	0	0	600,000.00
Shitje Dokumenta ankandi	4,000.00	2,000.00	2,000.00	3,000.00	2,000.00
Gjoha policia bashkiake	1,540,500.00	1,000,000.00	820,000.00	964,500.00	1,100,000.00
Gjoha për vonesë në pagesë	6,186,820.73	5,000,000.00	4,238,245.91	5,104,993.91	5,300,000.00
Gjoha inspektoriatit i ndërtimit	1,302,000.00	2,000,000.00	703,000.00	706,000.00	2,000,000.00
Gjoha të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	340,500.00	320,000.00	110,000.00	160,000.00	150,000.00
Gjoha të D.T.T.V	160,000.00	100,000.00	40,000.00	80,000.00	100,000.00
Qira objekti,Qera Trualli,Qera T.bujqësore	5,175,093.20	11,700,919.00	7,038,136.20	7,246,656.20	8,993,119.00
Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	510,000.00	440,000.00	390,000.00	425,000.00	350,000.00
Tarifë për leje ndërtimi	190,000.00	140,000.00	202,500.00	212,000.00	110,000.00
Tarifë servituti	508,116.00	1,000,000.00	780,948.00	780,948.00	912,343.00
Të ardhura nga qiratë, banesa sociale	7,067,514.00	6,696,950.00	5,642,867.00	6,194,959.00	6,372,000.00
Qira nga banesat në pronësi të Bashkisë Korçë,Enti Kombëtar i Banesave	2,855,633.00	3,300,000.00	2,059,025.00	2,223,767.00	2,500,000.00



BASHKIA KORÇË

Kamatë vonesa(qira objekti)	449,054.00	500,000.00	129,954.00	168,785.00	300,000.00
Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte	0	3,500,000.00	0	0	2,500,000.00
Tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues	0	18,420,000.00	3,842,700.00	4,842,700.00	27,652,800.00
TOTALI	650,610,416.30	951,907,328.88	500,348,139.75	559,409,221.82	860,294,797.00

	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Të ardhura ndër vite	650,610,416.30	559,409,221.82	860,294,797

1. TAKSA MBI NDËRTESEN

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksë mbi ndërtesën	96,209,399.22	91,074,524.38	205,372,856

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2021 planifikohet të jetë në vlerën 205,372,856 lekë.

Kjo taksë planifikohet të arkëtohet nga 4,473 njësi pronësore me sipërfaqe të përgjithshme prej 656,372.56 m² në vlerën 57,762,264 lekë, njësi pronësore këto që shfrytëzohen nga subjektet e biznesit të vogël, subjektet e biznesit të madh, O.J.F apo njësi në pronësi të individëve të destinuar për veprimtari social-ekonomike të cilët nuk i kanë vënë në shfrytëzim.

Në njësinë administrative Korçë sipërfaqja prej 488,138.65 m² për 3,989 njësi pronësore detajohet si më poshtë:

- 2,719 njësi pronësore me sipërfaqe 248,030.22 m² të destinuar për tregëti dhe shërbime në vlerën 34,079,352 lekë.
- 52 njësi pronësore me sipërfaqe 60,380.95 m² të destinuar për prodhim në vlerën 2,765,448 lekë.
- 1,121 njësi pronësore me sipërfaqe 162,787.24 m² të destinuar për magazina si dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet në vlerën 7,455,656 lekë.
- 97 njësi pronësore me sipërfaqe 16,940.24 m² të destinuar për bodrume dhe parkinge të mbuluara në pronësi të subjekteve të biznesit me vlerë 1,629,312 lekë.

Në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë sipërfaqja prej 168,233.91 m² për 484 njësi pronësore detajohet si më poshtë:

- 399 njësi pronësore me sipërfaqe 92,723.41 m² të destinuar për tregëti dhe shërbime në vlerën 8,298,745 lekë.
- 70 njësi pronësore me sipërfaqe 63,363.3 m² të destinuar për prodhim në vlerën 2,902,039 lekë.
- 5 njësi pronësore me sipërfaqe 6,361.2 m² të destinuar për blegtori në vlerën 113,865 lekë.
- 10 njësi pronësore me sipërfaqe 5,786 m² të destinuar për magazina si dhe objekte në të cilat nuk ushtrohet aktivitet në vlerën 517,847 lekë.

Nga familjarët e njësisë administrative Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 81,669,077 lekë nga



BASHKIA KORÇË

18,308 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 3,587,185 m².

- 17,138 njësi pronësore me sipërfaqe 3,519,143 m² të destinuar për banim në vlerën 80,588,363 lekë.
- 1170 njësi pronësore me sipërfaqe 68,042 m² të destinuar për garazh dhe bodrume në vlerën 1,090,713 lekë.

Nga familjarët e njërive të tjera administrative të Bashkisë Korçë planifikohet të arkëtohet në vlerën 12,440,540 lekë nga 7,784 njësi pronësore që taksohen për banim me sipërfaqe 840,577 m².

Nga debitorët e subjekteve të biznesit apo individëve të cilët zotërojnë njësi pronësore të destinuar për aktivitet social-ekonomik, si dhe nga njësitë pronësore në të cilat nuk ushtrohet aktivitet, në vlerën 36,547,057 lekë.

Nga debitorët familjarë në njësinë administrative Korçë në vlerën 9,138,827 lekë.

Nga debitorët familjarë në njësitë e tjera administrative të Bashkisë Korçë në vlerën 7,805,091 lekë.

Theksojmë këtu se ndikim negativ në këtë planifikim kanë pasur lehtësitë fiskale të ndërmara nga Bashkia Korçë. Për vitin 2020 janë përjashtuar 5,808 familje me njësi pronësore për banim me sipërfaqe totale 643,734.98 m², konkretisht në njësinë administrative Korçë 4,369 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 476,268.91 m² dhe 1,439 familje me njësi pronësore me sipërfaqe totale për banim 167,466.07 m² në njësitë e tjera administrative me vlerë totale prej 13,254,293 lekë.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse janë Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha.

Ndikim të theksuar në planifikimin e kësaj takse për vitin 2021 krahasuar me ato të viteve të mëparëshme ka pasur informacioni i shkëmbyer me A.SH.K në lidhje me inventarizimin e plotë të të gjitha njërive pronësore të destinuar për biznes apo banim.

2. TAKSA MBI TRUALLIN

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksë Trualli	8,109,107	8,131,745	20,967,766

Taksa mbi truallin për vitin 2021 planifikohet të jetë në vlerën 20,967,766 lekë.

- Nga subjektet e biznesit në Bashkinë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 456 njësi pronësore me sipërfaqe 568,139.81 m² në vlerën 10,226,517 lekë.
- Nga familjarët e Bashkisë Korçë planifikohen të arkëtohen nga 15,965 njësi pronësore me sipërfaqe 6,349,713,55 m² në vlerën 2,666,880 lekë.
- Nga debitorët e biznesit në vlerën 6,892,455 lekë.
- Nga debitorët familjarë në vlerën 1,181,915 lekë.

Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe agjenti tatimor U.K.KO. Sha. Ndikim të theksuar në planifikimin e kësaj takse për vitin 2021 krahasuar me ato të viteve të mëparëshme ka pasur informacioni i shkëmbyer me A.SH.K në lidhje me inventarizimin e plotë të të gjitha njërive pronësore për qëllime biznesi apo për qëllime banimi banim.



BASHKIA KORÇË

3. TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa mbi tokën bujqësore	17,871,800.90	17,554,042	50,984,382

Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2021 është planifikuar 50,984,382 lekë prej 52,859 njësi pronësore në njësinë administrative Korçë dhe njësitë e tjera me një sipërfaqe prej 10,457.39 ha, konkretisht:

Nr	Njësia administrative	Nr / prona	Sip / hektar	Vlera / lekë
1	Njësia administrative Korçë	980	369	722,925
2	Njësia administrative Bulgarec	13,732	3,067	6,134,172
3	Njësia administrative Drenovë	21,896	2,064	4,127,418
4	Njësia administrative Mollaj	3,066	810	1,619,298
5	Njësia administrative Vithkuq	1,032	1,235	2,017,990
6	Njësia administrative Voskop	8,160	2,072	4,143,143
7	Njësia administrative Voskopoje	3,472	523	1,045,483
8	Njësia administrative Lekas	521	317	443,800

Gjithashtu në planifikimin për vitin 2021 një ndikim të ndjeshëm kanë dhe debitorët vlera e të cilëve përlllogaritet në masën 30,730,153 lekë, debi kjo e përlllogaritur për pronarët apo poseduesit e tokës bujqësore të cilët nuk e kanë paguar këtë taksë për vitin 2020 dhe për periudhën paraardhëse. Strukturat përgjegjëse për arkëtimin e kësaj takse, po vijojnë punën intensivisht në bashkëpunim të ngushtë dhe me Agjensinë Shtetërore të Kadastrës për konsolidimin e bazës së të dhënave për taksapaguesit dhe saktësimin e sipërfaqeve.

4. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	9,161,810.37	3,053,456.02	11,000,000

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë. Planifikimi për vitin 2021 do të jetë 11,000,000 lekë, duke ju referuar të dhënave nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.

5. TAKSA E REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË MJETEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor	41,140,294	38,623,152	43,000,000



BASHKIA KORÇË

Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor për vitin 2021 është planifikuar 43,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë me shkresën Nr.7481/1 prot, datë 12.10.2020 e cila referuar pikës 3, të Nenit 4 të Ligjit 9975, në rolin e agjentit tatimor, arkëton detyrimin nga pronari i mjetit për vlerën e taksës për automjetin, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor. Ky parashikim është bërë nga D.R.SH.T.R-Korçë bazuar në realizimin e viteve paraardhëse, ndryshimet e fundit ligjore si dhe në të dhënat e disponuara për periudhën Janar – Shtator të vitit 2020.

6. TATIMI I THJESHUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	5,555,847.66	5,251,827	6,876,731

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël për vitin 2021 parashikohet të jetë 6,876,731 lekë, parashikim ky i bërë nga të dhënat e mara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë në lidhje me debitorët sipas shkresës nr 15689 prot. datë 14.12.2020, pasi ndyshimi i shkallës tatimore nga 5 (pesë) për qind në 0 për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë lehtëson dhe përjashton të gjitha subjektet e kësaj fashe nga pagimi i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2021.

7. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	87,219,242	52,767,130	58,000,000

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2021 planifikohet në vlerën 58,000,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

8. TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA LEGALIZIMET

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	13,435,258	4,921,475	23,873,515

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet për vitin 2021 është planifikuar 23,873,515 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë nga objektet e legalizuara theksojmë se parashikimi për këtë taksë është i ndërthurur me punën e A.SH.K.

Ky planifikim në masën 23, 873,515 lekë vjen si rezultat nga parashikimi i të ardhurave që do të mblidhen



BASHKIA KORÇË

gjatë vitit 2021 në vlerën 2,000,000 lekë si dhe detyrimeve debitore në vlerën 21,873,515 lekë.

9. TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2019
Taksa e fjetjes në hotel	5,754,310	4,196,754	5,000,000

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2021 i taksës së fjetjes në hotel është bërë duke u bazuar në numrin e njësive që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim si dhe kapacitet akomoduese të tyre.

Kjo taksë për vitin 2021 planifikohet në vlerën 5,000,000 lekë nga 101 subjekte (Bujtina/ Hotele) të detajuara si më poshtë:

- 27 bujtina me kapacitet akomodues 379 persona
- 74 hotele me kapacitet akomodues 2310 persona

Gjithashtu pritet që gjatë vitit 2021 të hyjnë në funksionim 5 bujtina dhe 10 hotele të cilët aktualisht janë duke investuar në këtë fushë. Arkëtim gjatë vitit 2021 do të ketë dhe nga ato subjekte të cilat nuk do ta paguajnë këtë taksë brenda vitit 2020 për vetë faktin se taksën e fjetjes në hotel për muajin dhjetor subjektet e paguajnë brenda datës 5 Janar të vitit 2021, gjithashtu dhe nga ato subjekte që nuk kanë paguar brenda afatit të përcaktuar këstet mujore të vitit 2020 apo dhe debitorë të viteve të mëparshme të cilat do të jenë objekt i masave shtrënguese konform legjislacionit në fuqi.

10. TAKSA E TABELËS

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Taksa e Tabelës	8,140,330	7,420,958	7,429,050

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

Tabela për qëllime identifikimi, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve .

Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Taksa e tabelës për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 7,429,050 lekë, parashikim ky nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit i cili bazohet në administrimin dhe pasurimin e të dhënave për numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese për orientim, numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë identifikuese mbi 2 m² dhe sipërfaqen e tyre si dhe numrin e subjekteve që kanë vendosur tabelë



BASHKIA KORÇË

reklamuese dhe sipërfaqen e tyre të ndodhura në Bashkinë Korçë si dhe ato që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2021. Konkretisht kjo taksë planifikohet të arkëtohet nga subjektet që do të vendosin një të tillë përgjatë vitit 2021, nga 48 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë reklamuese sipas përcaktimeve dhe niveleve të percaktuara në ligj, me sipërfaqe totale prej 224.53 m² në vlerën 5,051,950 lekë, nga 34 subjekte që aktualisht kanë vendosur tabelë për qëllime identifikimi sipas përcaktimeve dhe niveleve të percaktuara në ligj me sipërfaqe totale prej 153.35 m² në vlerën 2,135,350. Gjithashtu po gjatë vitit 2021 planifikohen të mblidhen dhe detyrimet të cilat nuk arritën të mblidheshin për vitin 2020 dhe ato më përpara në vlerën 241,750 lekë.

11. DIVIDENTI NGA U.K.KO

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Dividenti nga U.K.KO	15,515,582	661,319	5,000,000

Dividenti nga U.K.KO për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 5,000,000 lekë planifikim ky i kryer nga ndërmarja e U.K.KO.

12. RENTA MINERARE

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Renta minerare	575,607	395,906	200,000

Çdo person fizik apo juridik, që është i licensuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Taksa e rentës minerare arkëtohet në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit ose në rastin e eksportit të produkteve minerare. Baza e taksës janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Struktura e mbledhjes e kësaj takse janë: degët e doganave në rrethe të cilat ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Për vitin 2021 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën 200,000 lekë bazuar nga të dhënat e mara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

13. TARIFË REGJISTRIMI PËR LEJË TRANSPORTI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,605,680	1,084,520	910,000

Tarifë regjistrimi për leje transporti për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 910,000 lekë planifikim ky i bërë nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit me shkresën nr.7250/1 datë 09.10.2020. Sipas kategorizimit ky parashikim do të realizohet si më poshtë:



BASHKIA KORÇË

1. Transporti i udhëtarëve me taksi planifikohet në vlerën 400,000 lekë (nga rinovimi i liçencave që përfundojnë gjatë vitit 2020).
2. Transporti i mallarave planifikohet në vlerën 360,000 lekë (në këtë kategori pjesën kryesore e zënë automjetet e subjekteve të ndërtimit me tonazh të lartë. Sipas kërkesave të subjekteve këto automjete në pjesën më të madhe janë pajisur me çertifikata dhe autorizime me afat mbi 1-vjeçar).
3. Transporti i udhëtarëve me autobusë planifikohet në vlerën 150,000 lekë. Parashikimi këtu përfshin edhe pajisjen me çertifikata të autobusëve të subjekteve ekzistuese, si rrjedhojë e shtimit apo rinovimit të automjeteve.

14. TARIFË THERJE BAGËTIE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë therje bagëtie	2,175,500	1,185,898	1,446,733

Tarifë therje bagëtie për vitin 2021 është planifikuar 1,446,733 lekë, parashikim ky i Drejtorisë së Kontrollit të Territorit. Ky planifikim në masën 1,446,733 lekë vjen si rezultat nga parashikimi i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit 2021 në vlerën 1,255,320 lekë si dhe detyrimeve debitoare në vlerën 191,413 lekë.

Masat e mara për mbikqyrjen e sigurisë ushqimore, formalizimit të tregut, parandalimit të therjes së kafshëve në vende ilegale si dhe disiplinimin e therjes së kafshëve dhe tregimit të mishit në të gjithë territorin e Bashkisë Korçë do të ndikojnë ndjeshëm në realizimin e kësaj tarife.

15. TARIFË MUR PERIMETRAL

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë mur perimetral	1,092,020	730,960	650,000

Tarifë mur perimetral për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 650,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

16. TARIFA E PASTRIMIT

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifa e Pastrimit	158,711,064.88	146,416,166	195,879,182

Tarifa e pastrimit për vitin 2021 planifikohet në vlerën 195,879,182 lekë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,714 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 26,280,800 lekë
- 640 subjekte të biznesit të madh në vlerën 34,068,000 lekë
- 80 institucione shtetërore dhe ojf në vlerën 2,370,000 lekë



BASHKIA KORÇË

- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2020 në vlerën 2,500,000 lekë,
- 20,498 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 77,892,400 lekë
- 8,310 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 12,369,000 lekë
- debitorët familjarë në vlerën 18,636,004 lekë
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 21,762,978 lekë.

Në planifikimin e tarifës së pastrimit ndikim negativ kanë dhe lehtësitë fiskale apo përjashtimet e kësaj tarife. Për vitin 2021 vlera prej 2,270,200 lekë do të mungojë buxhetit të bashkisë por do jetë në buxhetet e sipërmarrjeve private si një mundësi për shtim dhe rritjen e kapaciteteve, aktiviteteve, punësimit, zgjerimit e.t.j

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprase që disponojmë janë 52 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 489,200 lekë :

- 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 230,000 lekë
- 12 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 192,000 lekë
- 17 Institucione arsimore private në vlerën 67,200 lekë

2. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së pastrimit, referuar të dhënave paraprase që disponojmë janë 21 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 581,000 lekë :

- 3 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 75,000 lekë
- 11 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 440,000 lekë
- 2 Ojft sportive në vlerën 30,000 lekë
- 5 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 36,000 lekë

3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së pastrimit referuar të dhënave paraprase që disponojmë janë 25 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 1,200,000 lekë :

- Nga 9 subjekte të biznesit në vlerën 720,000 lekë
- Nga 16 Ojft fetare në vlerën 480,000 lekë

Tarifa e pastrimit mbledhet nga dy struktura, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga U.K.KO.

17. TARIFE NDRIÇIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë Ndrichi	35,295,758.17	32,226,384.17	45,261,479

Tarifa e ndriçimit për vitin 2021 planifikohet në vlerën 45,261,479 lekë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

- 2,714 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 11,290,100 lekë
- 640 subjekte të biznesit të madh në vlerën 5,401,200 lekë
- 80 institucione shtetërore dhe ojft në vlerën 395,000 lekë
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2020 në vlerën 185,000 lekë



BASHKIA KORÇË

- 20,498 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 14,348,600 lekë
- 8,310 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 4,131,000 lekë
- debitorët familjarë në vlerën 3,980,480
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 5,530,099 lekë.

Në planifikimin e tarifës së ndriçimit ndikim negativ kanë dhe lehtësitë fiskale apo përjashtimet e kësaj tarife. Për vitin 2021 vlera prej 275,100 lekë do të mungojë buxhetit të bashkisë por do jetë në buxhetet e sipërmarjeve private si një mundësi për shtim dhe rritjen e kapaciteteve, aktiviteteve, punësimit, zgjerimit e.t.j

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 52 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 73,600 lekë :

- 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 41,400 lekë
- 12 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 14,400 lekë
- 17 Institucione arsimore private në vlerën 17,800 lekë

2. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së ndriçimit, referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 21 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 67,500 lekë :

- 3 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 13,500 lekë
- 11 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 33,000 lekë
- 2 Ojft sportive në vlerën 5,000 lekë
- 5 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 16,000 lekë

4. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së ndriçimit referuar të dhënave paraprake që disponojmë janë 25 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 134,000 lekë :

- 9 subjekte të biznesit në vlerën 54,000 lekë
- 16 Ojft fetare në vlerën 80,000 lekë

Tarifa e ndriçimit mbledhet nga dy struktura, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga U.K.KO.

18. TARIFË GJELBËRIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë Gjellbërimit	23,404,849.37	21,230,975.95	28,784,320

Tarifa e gjellbërimit për vitin 2021 planifikohet në vlerën 28,784,320 lekë.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga :

- 2,339 subjekte të biznesit të vogël në vlerën 9,219,850 lekë
- 640 subjekte të biznesit të madh në vlerën 3,053,000 lekë
- 80 institucione shtetërore dhe ojft në vlerën 395,000 lekë
- subjektet ndërtuese për kantieret e ndërtimit referuar numrit të lejeve të dhëna gjatë vitit 2020 në vlerën 250,000 lekë
- 20,498 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 10,249,000 lekë
- debitorët familjarë të njësisë administrative Korçë në vlerën 1,576,295 lekë
- debitorët e subjekteve të biznesit parashikohet në vlerën 4,041,175 lekë.



BASHKIA KORÇË

Në planifikimin e tarifës së gjelbërimit ndikim negativ kanë dhe lehtësitë fiskale apo përjashtimet e kësaj tarife. Për vitin 2021 vlera prej 310,850 lekë do të mungojë buxhetit të bashkisë por do jetë në buxhetet e sipërmarjeve private si një mundësi për shtim dhe rritjen e kapaciteteve, aktiviteteve, punësimit, zgjerimit e.t.j

1. Subjekte të cilat përfitojnë 20 % ulje të tarifës së gjelbërimit, referuar të dhënave paraprahe që disponojmë janë 52 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 62,100 lekë :

- 23 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 23,000 lekë
- 12 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 24,000 lekë
- 17 Institucione arsimore private në vlerën 15,100 lekë

2. Subjekte të cilat përfitojnë 50 % ulje të tarifës së gjelbërimit, referuar të dhënave paraprahe që disponojmë janë 21 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 78,750 lekë :

- 3 subjekte për aktivitetin tregëti dhe shërbime në vlerën 7,500 lekë
- 11 subjekte për aktivitetin prodhim në vlerën 55,000 lekë
- 2 Ojft sportive në vlerën 5,000 lekë
- 5 subjekte dedikuar fëmijëve në vlerën 11,250 lekë

3. Subjekte që përjashtohen nga pagesa e tarifës së gjelbërimit referuar të dhënave paraprahe që disponojmë janë 25 subjekte me një ndikim në buxhetin e bashkisë me një vlerë prej 170,000 lekë :

- 9 subjekte të biznesit në vlerën 90,000 lekë
- 16 Ojft fetare në vlerën 80,000 lekë

Tarifa e gjelbërimit mbliidhet nga dy struktura, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe nga U.K.KO.

19. TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë mirëmbajtje varreza publike	12,948,926	12,042,677	17,654,037

Tarifë mirëmbajtje varreza publike për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 17,654,037 lekë.

Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga 20,498 familje rezidente efektive të njësisë administrative Korçë në vlerën 10,249,000 lekë, nga 8,310 familje rezidente efektive të njësisë administrative të tjera të Bashkisë Korçë në vlerën 4,131,000 lekë si dhe nga debitorët familjarë parashikohet në vlerën 3,274,037 lekë. Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike mbliidhet nga dy struktura, nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe U.K.KO në lidhje me tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike për kategorinë familjarë.

20. TARIFË PËR ZËNIE TË HAPËSIRAVE PUBLIKE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë për zënien e hapësirave publike	21,024,032	14,031,439	25,913,941

Tarifë për zënien e hapësirave publike për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 25,913,941 lekë, bazuar në parashikimin e Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për sipërfaqet dhe zënien e hapësirës publike të cilat përdoren dhe do të përdoren për qëllime të ndryshme siç janë zënia e hapësirave publike për shërbim me



BASHKIA KORÇË

tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash, rrethim me kangjella, rrethim me vazo lule, etj, zënia e hapësirave publike për tregëtim në tregje publike të miratuara nga bashkia të artikujve ushqimore, fruta – perime, vezë, mish, peshk, bulmet, e.t.j, zënia e hapësirave publike për tregëtim tek inkubatori i biznesit (ish UMB) të artikujve industrial, zënia e hapësirave publike për organizim evente të ndryshme, panaire, zënia e hapësirave publike për tregëtim të artikujve industriale të artikujve ushqimore, fruta – perime, kantina, kënde lojrash etj. Konkretisht më poshtë po paraqesim informacionin e përfutur nga viti 2020 e cila shërben si bazë për planifikimin e kësaj tarife për vitin 2021.

- Nga 176 subjekte tregëtare në tregun industrial dhe atë të veshjeve të përdorura me sipërfaqe totale prej 652 m² për të cilat tarifa e zënies së hapësirës publike referuar legjislacionit në fuqi i cili ka përcaktuar vlerën prej 15 lekë/m²/ditë do të arkëtohet gjatë vitit 2020 në vlerën 3,520,800 lekë.
 - Nga 20 subjekte tregëtare me sipërfaqe 523 m² për të cilat tarifa e zënies së hapësirës publike referuar legjislacionit në fuqi i cili ka përcaktuar vlerën prej 150 lekë/muaj/m² do të arkëtohet gjatë vitit 2020 në vlerën 941,400 lekë.
 - Nga 33 dyqane/kioska për tregëtim fruta perime, bulmet, ushqimore, artikuj të përziere etj të ngjashme me to në vlerën 3,144,000 lekë.
 - Nga 24 bankina për tregëtim fruta perime, ushqimore, ullinj, erëza, artikuj të përziere etj të ngjashme me to në vlerën 2,136,000 lekë.
 - Nga 1 ambiente për tregëtimin e mishit dhe nënprodukteve të tij në vlerën 228,000 lekë.
 - Nga 1 ambient për tregëtimin e peshkut në vlerën 240,000 lekë.
 - Nga subjektet të cilët shërbejnë me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike në vlerën 10,635,315 lekë
 - Nga subjektet të cilat ekspozojnë mallin jashtë dyqanit në vlerën 843,538 lekë.
 - Nga subjektet të cilat shfrytëzojnë hapësirën publike me automjet tip kantinë me aktivitet fast-food në vlerën 120,400 lekë.
 - Nga subjektet të cilat kërkojnë periodikisht çdo vit për të kryer promocione në territorin e Bashkisë Korçë në vlerën 162,680 lekë.
 - Nga debitorët të cilët nuk e kanë paguar këtë tarifë deri në vitet 2019-2020 në vlerën 3,941,808 lekë.
- Në planifikimin e tarifës për zënie e hapësirave publike ndikim negativ ka dhe përjashtimi i cili u miratua së fundmi ku subjektet që shërbejnë me tavolina jashtë lokaleve nuk do të paguanë këtë tarifë për muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor. Konkretisht në planifikim e kësaj tarife për vitin 2021 vlera prej 2,200,000 lekë do ti mungojë buxhetit të Bashkisë por do jetë në buxhetet e sipërmarrjeve private si një mundësi për shtim dhe rritjen aktiviteteve, punësimit, zgjerimit e.tj

21. TARIFË PARKIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë Parkimi	18,707,966	14,423,644	20,839,207

Tarifë parkimi për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 20,839,207 lekë, planifikim ky i kryer nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit bazuar në :

- 48 subjekte të cilat kanë rezervuar 71 vende parkimi me interval të ndryshëm kohor në vlerën 2,500,000 lekë
- 283 vend parkime me pagesë në vlerën 14,850,000 lekë



BASHKIA KORÇË

- Tarifa e parkimit rezident parashikohet në vlerën 75,000 lekë
- në numrin e mjeteve që transportojnë mall për llogari të vet, për të tretë në vlerën 230,000 lekë
- 78 liçensa për mjetet taksi (1+4) dhe 10 liçensa për mjetet taksi (1+8) parashikohet në vlerën 392,000 lekë
- 52 subjekte debitorë nga vitet 2019-2020 që do të paguajnë këtë taksë gjatë vitit 2021 si rezultat i masave shtrënguese në vlerën 2,792,207 lekë.

22. TË ARDHURA TË TJERA

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Të ardhura të tjera	11,362,845	36,273,780	13,229,337

Të ardhura të tjera (tarifa shërbimi, vërtetime, certifikata, etj) për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 13,229,337 lekë, parashikim ky i bazuar në të dhënat e mara nga drejtoritë apo institucionet përkatëse.

23. ÇERTIFIKATË PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Çertifikatë për mbrojtjen nga zjarri	1,517,600	1,768,100	260,000

Të ardhura nga certifikatë për mbrojtjen nga zjarri për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 260,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori gjatë vitit 2021 priten të lëshohen për herë të parë 46 certifikata për mbrojtjen nga zjarri si dhe të rinovohen 20 certifikata ekzistuese.

24. MIRATIM PROJEKTI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Miratim projekti	562,450	415,200	200,000

Të ardhura nga miratim projekti për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 200,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

25. SHËRBIME ZJARRFIKSE NË OBJEKTE TË SIGURUARA

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruar	-	-	30,000

Të ardhura nga shërbime zjarrfikëse në objekte të siguruar për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 30,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

26. SHËRBIME ZJARRFIKSE NDAJ TË TRETËVE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Shërbime zjarrfikëse ndaj të tretëve	-	-	50,000

Të ardhura nga shërbime zjarrfikëse ndaj të tretëve për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 50,000 lekë,



BASHKIA KORÇË

parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

27. MARRJE ME QIRA PYLLI / KULLOTA

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Marrje me qira pylli / kullota	13,941,945.50	8,323,240.19	10,000,000

Marrje me qira pylli / kullota për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë bazuar në kontratat ekzistuese, ato që priten të lidhen apo rilidhen gjatë vitit 2021 kryesisht:

- Kontrata qiraje me qëllim pushim argëtim në vlerën 159,750 lekë
- Kontrata qiraje për akuakulturë në vlerën 38,200 lekë.
- Kontrata qiraje me kompanitë celulare në vlerën 1,326,750 lekë.
- Kontrata qiraje për mbjellje arrorësh në vlerën 633,000 lekë.
- Kontrata qiraje për kullotje në vlerën 1,400,000 lekë.
- Kontrata qiraje për ndërtim HEC në vlerën 6,442,300 lekë.

28. TË ARDHURA NGA SHITJA E DRUVE TË ZJARRIT DHE HEQJA E MATERIALIT DRUSOR

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor	12,540,960	6,009,640	2,500,000

Të ardhura nga shitja e druve të zjarrit dhe heqja e materialit drusor për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 2,500,000 lekë nga lidhja e një kontrate për shfrytëzimin e materialit drusor, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

29. VËRTETIME TRANSPORTI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Vërtetime transporti	78,000	81,000	40,000

Të ardhura nga vërtetime transporti për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 40,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë ku bazuar në ecurinë e vitit 2020 parashikohet të shiten rreth 13 blloqe me vërtetime transporti.

30. TË ARDHURA NGA PRODHIMET E DYTA MEDICINALE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Prodhimet e dyta medicinale	663,000	-	600,000



BASHKIA KORÇË

Të ardhura nga prodhimet e dyta medicinale për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 600,000 lekë, si rezultat i shitjes së BMET si Dëllinjë e Kuqe dhe Dëllinjë e Zezë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë.

31. SHITJE DOKUMENTA ANKANDI

Lloji i taksës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Shitje Dokumenta ankandi	4,000	3,000	2,000

Të ardhura shitje dokumenta ankandi për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 2,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe e Pyjores pranë Bashkisë Korçë si rezultat i kryerjes së dy ankandeve.

32. GJOBA POLICIA BASHKIAKE

Lloji i gjobës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Gjoba Policia Bashkiake	1,540,500	964,500	1,100,000

Gjoba Policia Bashkiake për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 1,100,000 lekë duke përfshirë dhe gjobat e pa mbledhura gjatë vitit ushtrimor korent apo atij të mëparshëm.

33. GJOBË PËR VONESË NË PAGESË

Lloji i gjobës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Gjobë për vonesë në pagesë	6,186,820.73	5,104,993.91	5,300,000

Gjobë për vonesë në pagesë për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 5,300,000 lekë, parashikim ky i bazuar në detyrimet e papaguara të viteve të mëparshme, detyrimet e subjekteve të cilët nuk arritën që të kryenin pagesat brenda vitit ushtrimor për të cilat gjoba për vonesë në pagesë vazhdon të përlllogaritet, si dhe në ecurinë e vitit aktual.

34. GJOBA TË INSPEKTORIATIT NDËRTIMOR VENDOR

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor	1,302,000	706,000	2,000,000

Gjoba të Inspektoriatit Ndërtimor Vendor për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 2,000,000 lekë duke përfshirë këtu dhe gjobat e pa mbledhura nga vitet e mëparshme apo ato që janë në proces gjyqësor apo kanë kaluar në përmbarrim për ekzekutim.

35. GJOBA TË DREJTORISË SË KONTROLLIT TË TERRITORIT

Lloji i gjobës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit	340,500	160,000	150,000

Gjoba të Drejtorisë së Kontrollit të Territorit për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 150,000 lekë duke përfshirë këtu dhe gjobat e pa mbledhura gjatë vitit ushtrimor korent apo atij të mëparshëm.

36. GJOBA TË D.T.T.V

Lloji i gjobës	REALIZIM	PLANIFIKIM
----------------	----------	------------

**BASHKIA KORÇË**

	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Gjoha të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore	160,000	80,000	100,000

Gjoha të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 100,000 lekë, referuar dhe ecurisë të vitit aktual.

37.QIRA OBJEKTI/TRUALLI/TOKË BUJQËSORE E.T.J

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Qira objekti/trualli/tokë bujqësore e.t.j	5,175,093.20	7,246,656.20	8,993,119

Qira objekti, trualli, tokë bujqësore e.t.j për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 8,993,119 lekë, bazuar në numrin dhe sipërfaqen e objekteve dhe pronave që Bashkia ka lëshuar me qira konkretisht :

- Qira objekti 7,531,980 lekë
- Qira trualli 1,286,728 lekë
- Qira tokë bujqësore 174,411 lekë

38.TARIFË VENDORE PËR SHQYRTIM LEJE ZHVILLIM

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	510,000	425,000	350,000

Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 350,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

39.TARIFË PËR LEJË NDËRTIMI

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë për lejë ndërtimi	190,000	212,000	110,000

Tarifë për lejë ndërtimi për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 110,000 lekë parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit. Në lidhje me parashikimin e kësaj tarife i jemi referuar realizimit të 3 viteve të fundit si dhe ndryshimeve në paketën fiskale të vitit 2020. Gjithashtu ndikim do të ketë dhe efekti i ndërtimeve (meremetime, rikonstruksione dhe rindërtime) për të zhdukur dëmet e shkaktuara nga tërmetet e shpeshta të gjysmës së dytë të vitit 2019, të cilat sipas ndryshimit të legjislacionit do të trajtohen me 0 taksë.

40.TARIFË PËR SERVITUTIN E KALIMIT NË PRONAT PUBLIKE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike	508,116	780,948	912,343

Tarifë për servitutin e kalimit në pronat publike për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 912,343 lekë duke u bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria e Kontrollit të Territorit e cila ka inventarizuar dhe matur në terren sipërfaqet që kanë zënë pronë publike në funksion të aktivitetit të tyre. Ky planifikim në masën 912,343 lekë vjen si rezultat nga parashikimi i të ardhurave që do të mblidhen gjatë vitit 2021 në vlerën 689,501 lekë si dhe detyrimeve debitoare në vlerën 222,842 lekë.

41.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESAT SOCIALE)



BASHKIA KORÇË

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Të ardhura nga qiratë (banesa sociale)	7,067,514	6,194,959	6,372,000

Të ardhura nga qiratë (banesa sociale) për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 6,372,000 lekë. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me qëllim social me shkresën nr 31 prot dt.12/10/2020, bazuar në numrin dhe sipërfaqet e apartamenteve që disponojnë, e detajuar si më poshtë :

- Banesa nr 1. me 41 apartamente, qiraja vjetore 2,635,200 lekë
- Banesa nr 2. me 29 apartamente, qiraja vjetore 1,868,400 lekë
- Banesa nr 3. me 29 apartamente, qiraja vjetore 1,868,400 lekë.

42.TË ARDHURA NGA QIRATË (BANESA NË PRONËSI TË BASHKISË ENTI I BANESAVE)

Lloji i taksës ose tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Të ardhura nga qiratë (banesa në pronësi të Bashkisë nga enti i banesave)	2,855,633	2,223,767	2,500,000

Të ardhura nga qiratë (banesa që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave) për vitin 2021 parashikohet në vlerën 2,500,000 lekë konkretisht:

Banesa sociale të dorëzuara nga E.K.B, 39 apartamente me vlerë qiraje vjetore 2,500,000 lekë.

43.KAMAT VONESA

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Kamat vonesa (qira objekti)	449,054	168,785	300,000

Këto kamatvonesa për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 300,000 lekë. Parashikim ky i Njesisë së Menaxhimit të Banesave me qëllim social si rezultat ky i mos pagimit në kohë të qirasë nga banesat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Korçë nga Enti Kombëtar i Banesave dhe i qirave të banesave sociale.

44.TARIFË PER DEPOZITIMIN E MBETJEVE INERTE

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte	-	-	2,500,000

Tarifë për depozitimin e mbetjeve inerte për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 2,500,000 lekë. Planifikimi i kësaj tarife është bërë nga Drejtoria Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të territorit bazuar në të dhënat që disponon kjo drejtori referuar vitit 2020 nga lejat e ndërtimeve për zërin “Gërmime dhe transport dheri dhe mbetje ndërtimore” e cila sipas preventivave zinte një volum rreth 41,600 m³.

45.TARIFË VJETORE E SHËRBIMIT DHE MIRËMBAJTJES TË RRUGËVE TË PARCELAVE DHE TË SISTEMIT KULLUES

Lloji i tarifës	REALIZIM		PLANIFIKIM
	2019	2020 (i pritshëm)	2021
Tarifë vjetore e shërbimit dhe	-	3,842,700	27,652,800



BASHKIA KORÇË

mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues		
---	--	--

Tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues për vitin 2021 është planifikuar në vlerën 27,652,800 lekë parashikim ky i bërë bazuar në informacionin e marrë nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, referuar kostove për pastrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit, mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave, çakullimin e tyre, vendosjes së tombinove apo dhe çdo lloj shërbimi që kjo e fundit kryen në funksion të bujqësisë për vënien në funksionalitet të komplet sistemit. Ky planifikim në masën 27,652,800 lekë vjen nga parashikimi i të ardhurave që do të mbledhen gjatë vitit 2021 bazuar në sipërfaqen prej 92,100 dynym tokë bujqësore në vlerën 13,815,000 lekë si dhe detyrimeve debitore në vlerën 13,837,800 lekë.

5.2. Të ardhurat nga institucionet e vartësisë

Për vitin 2021 të ardhurat nga institucionet e vartësisë janë planifikuar në vlerën **25,173 mijë** lekë.

Tabela 1: Të ardhurat e institucioneve për vitin 2021 (vlerat në 000/lekë)

<i>Emërtimi</i>	<i>Rea l 2019</i>	<i>Pl 2020</i>	<i>Pl 2020 I rishikuari</i>	<i>Fak t 10m</i>	<i>Pl I real te prtsh 2020</i>	<i>Pl 2021</i>	<i>Pl 21- Pl rish 20</i>
NSHMAÇ	9,760	20,000	11,000	4,383	7,022	21,000	10,000
NSHP	2,389	4,400	2,400	1,850	4,800	2,350	-50
QAK	4,507	3,620	1,700	770	3,100	1,760	60
Kl Shumesportesh	63	63	63	47	63	63	0
Shtëpia e Foshnjës		50	50				-50
Qendra Rezidenciale	155		8	8	8		-8
Qendra Ditore	39	50	50		15		-50
Total	16,913	28,183	15,271	7,058	15,008	25,173	9,902

6. Transfertat nga buxheti i shtetit

6.1. Transferta e pakushtëzuar

Transferta e pakushtëzuar do t'u sigurojë njësisë të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale dhe rajonale

Transferta e pakushtëzuar për vitin 2021 është në vlerën 452,393 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 3,359 mijë lekë.


Tabela 2: Tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	2017	2018	2019	2020	2021
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	395,385	419,527	439,016	449,034	452,393



BASHKIA KORÇË

Grafiku 1: Tranferta e pakushtëzuar e përgjithshme



6.2. Transfertat e pakushtëzuara sektoriale

Pjesa Sektoriale e Transfertës së Pakushtëzuar përfshin financimin për funksionet e reja të transferuara në nivel vendor në vitin 2016 sipas Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Funksionet nga transfertat e pakushtëzuara sektoriale jepen si më poshtë:

1. Arsim parashkollor (kopshtet e fëmijëve, edukatorë dhe punonjës në QKF/punonjës mbështetës,
2. Konviktet e arsimit parauniversitar
3. Personeli mbështetës i arsimit parauniversitar,
4. Rrugët rurale,
5. Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi,
6. Administrimi i pyjeve,
7. Ujitja dhe kullimi.

Tabela 3: Tranferta e pakushtëzuar e sektoriale (vlerat në 000/lekë)


Emërtimi	Real 2019	PI 2020	PI i real te pritshem 2020	PI 2021	PI 2022	PI 2023
Arsimi bazë dhe parashkollor (NSHMAC)	167,091	175,003	175,003	176,637	176,637	176,637
Arsimi profesional (NSHMAC)	20,219	21,881	21,881	21,881	21,881	21,881
Arsimi i mesëm i përgjithshëm (NSHMAC)	18,275	18,289	18,289	18,838	18,838	18,838
Mbrojtja nga zjarri dhe Mbrojtja Civile (Bashkia)	25,313	29,092	29,092	29,964	29,964	29,964



BASHKIA KORÇË

Administrimi i pyjeve dhe kullotave (Bashkia)	9,712	13,815	12,529	15,197	15,197	15,197
Menaxhimi I infrastruktures se ujitjes dhe kullimit (NSHP)	39,873	43,178	42,740	45,737	45,737	45,737
Rrjeti rrugor rural (NSHP)	5,073	6,521	6,433	6,521	6,521	6,521
Mbrojtja civile (transfera specifike)				13,691		
Total	285,556	307,779	305,967	328,466	314,775	314,775

Grafiku 2: Tranferta e pakushtëzuar sektoriale



Fondet nga transfera e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2021 kanë një rritje prej 6,995 mijë lekësh krahasuar me vitin 2020.

6.3. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor.

2. Edhe për vitin 2021, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga granti konkurrues për arsimin.

3. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve në proces. Fondi i Zhvillimit të Rajoneve nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

6.4. Transfera specifike

Në buxhetin e vitit 2021, do të akordohet për njësitë e vetëqeverisjes vendore si transfertë specifike për emergjencat civile në vlerën e 500 milion lekë. Ky fond është shpërndarë me një formulë e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive. Pjesën tjetër të fondit bashkitë mund ta sigurojnë nëpërmjet përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës ose/dhe pjesë nga buxhetet e tyre (transfera e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore). Ky fond i akorduar njësitë të vetëqeverisjes vendore së bashku me fondin që këto do të adresojnë përbën fillimin e një reforme të rëndësishme për mbrojtjen civile. Për Bashkinë Korçë fondi nga transfera specifike është



BASHKIA KORÇË

13,691 mijë lekë

7. Buxheti 2021


Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2021 do të jetë 1,666,478 mijë lekë dhe paraqitet sipas burimeve të financimit, sipas llogarive ekonomike, sipas institucioneve të detajuara si më poshtë:

-Sipas burimeve të financimit dhe e krahasueshme me vitet 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

Tabela 4: Burimet e financimit (vlerat në 000/lekë)

Burimet e financimit	PI 2019	PI 2020	PI 2020 I rish	2021	Dif pl 21-PI rish 20
Transferta e pakushtëzuar	439,016	449,034	449,034	452,393	3,359
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	307,447	307,780	307,780	314,776	6,996
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	950,379	913,282	807,521	860,295	52,774
Të ardhurat nga institucionet e varësisë	22,663	28,183	15,263	25,173	9,910
Të ardhurat e trashëguara për shp e vitit 2020		74,135	69,521		
Transferta specifike për mbrojtjen civile				13,691	13,691
Të ardhura të tjera				150	150
Total	1,719,505	1,772,414	1,649,119	1,666,478	17,359

Grafiku 3 : Burimet e financimit (PI 2019, 2020, PI i rish 2020, PI 2021)



Duke u bazuar në tabelën e mësipërme buxheti i vitit 2021 krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2020 ka një ulje prej 106,364 mijë lekësh dhe krahasuar me buxhetin e rishikuar ka një rritje prej 17,359 mijë lekësh.

Pesha specifike që këto burime zenë ndaj totalit të buxhetit janë si më poshtë:

Transferta e pakushtëzuar zë 27%

Transferta e pakushtëzuar sektoriale zë 19%

Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore zënë 52%



REPUBLIKA E KOSOVË

Të ardhurat nga institucionet e varësisë zënë 2%

Transferta specifike për mbrojtjen civile zënë 1%.

-Buxheti i vitit 2021 sipas llogarive ekonomike dhe e krahasueshme me vitet 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:

Tabela 5: Shpenzimet sipas llogarive ekonomike (vlerat në 000/lekë)

Shpenzimet	PI 2019	PI 2020	PI 2020 I rish	PI 2021	Dif pl 21-PI rish 20
Shpenzimet personeli (paga + sigurime)	644,806	650,714	648,635	712,650	64,015
Shpenzime korrente (shp op, shërbime publike, subv, tr tek individet, tr tek org, etj)	775,003	801,836	709,997	762,991	52,194
Projektet IPA	13,470	20,000	20,000	20,000	0
Shpenzime për investime	229,376	245,564	216,187	123,287	(92,900)
Principali dhe interes	56,850	54,300	54,300	47,550	(6,750)
Total	1,719,505	1,772,414	1,649,119	1,666,478	17,359

Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2021 krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 kanë një rritje prej 64,015 mijë lekë dhe me planin fillestar të buxhetit kanë një rritje prej 61,936 mijë lekësh dhe pesha që zenë ndaj totalit të buxhetit është 43%.

Shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet operative, subvencioni, shërbimet publike, transfertat tek organizatat dhe transfertat tek individët për vitin 2021 krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 kanë një rritje prej 52,194 mijë lekë dhe me planin fillestar të buxhetit kanë një ulje prej 38,845 mijë lekësh dhe pesha që zenë ndaj totalit të buxhetit është 46%.

Shpenzimet për investime për vitin 2021 krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 kanë një ulje prej 92,900 mijë lekë dhe me planin fillestar të buxhetit kanë një ulje prej 122,277 mijë lekësh dhe pesha që zenë ndaj totalit të buxhetit është 9%.

Shpenzimet për principalin dhe interesin e kredisë për vitin 2021 krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 dhe me planin fillestar të buxhetit kanë një ulje prej 6,750 mijë lekësh dhe pesha që zenë ndaj totalit të buxhetit është 3%.

-Buxheti 2021 sipas institucioneve dhe e krahasueshme me vitet 2020 dhe 2019 paraqitet si më poshtë:



BASHKIA E KOSOVË

000/lekë

Emertimi i Institucioneve	PI 2019	Det 2019	PI 2020	PI rish 2020	PI I rel te pr	PI 2021	Dif pl 21-PI20 rish	Dif PI21-PI I real te pr 20	Dif pl 21-PI20
NSHP	401,937	40,098	407,257	366,325	355,979	470,708	104,383	114,729	63,451
NSHMAC	376,584	17,418	391,266	373,284	350,143	388,209	14,925	38,066	(3,057)
KI Shumesportesh	33,523		34,673	33,193	28,424	32,642	(551)	4,218	(2,031)
Qendra e Artit dhe Kultures	92,675	8,496	89,205	72,016	57,453	75,987	3,971	18,534	(13,218)
NJMBQS	2,504	91	2,644	2,616	2,493	2,515	(101)	22	(129)
Bashkia	808,911	183,091	838,008	796,099	657,716	690,182	(105,917)	32,466	(147,826)
Qendra Ditore e Zhvillimit	550	27	550	550	260	550	-	290	-
Shtepia e Foshnjes	2,321		5,245	2,956	2,956	5,116	2,160	2,160	(129)
Qendra rezidenciale e Zhvillimit	500	24	3,566	2,080	2,080	570	(1,510)	(1,510)	(2,996)
Totali i Buxhetit	1,719,505	249,245	1,772,414	1,649,119	1,457,504	1,666,478	17,359	208,974	(105,936)

Buxheti i vitit 2021 krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2020 ka një ulje prej 105,936 mijë lekësh, krahasuar me buxhetin e rishikuar ka një rritje prej 17,359 mijë lekësh dhe krahasuar me planin e realizimit të pritshëm të vitit 2020 ka një rritje prej 208,974 mijë lekë.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në vlerën 470,708 mijë lekësh zë 28% ndaj totalit të buxhetit në vlerën 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes në vlerën 388,209 mijë lekësh zë 23% ndaj totalit të buxhetit në vlerë 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Klubin Shumësportësh në vlerën 32,642 mijë lekësh zë 2% ndaj totalit të buxhetit në vlerë 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Qendrën e Artit dhe Kulturës në vlerën 75,987 mijë lekësh zë 5% ndaj totalit të buxhetit në vlerë 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social në vlerën 2,515 mijë lekësh zë afërsisht 1% ndaj totalit të buxhetit në vlerë 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për Bashkinë në vlerën 689,754 mijë lekësh zë 41% ndaj totalit të buxhetit në vlerë 1,666,478 mijë lekësh.

Buxheti vjetor përbën vitin e parë të programit buxhetor afatmesëm dhe sipas ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 40, përfshin dokumentacionin bazë dhe dokumentacionin shoqërues si më poshtë:



BASHKIA KORÇË

7.1.Dokumentacioni bazë:

a) *fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale;*

Tabela 6: Fondet buxhetore, të parashikuara sipas programeve buxhetore për çdo njësi shpenzuese, për vitin e ardhshëm, të ndara në korrente dhe kapitale (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi I programit	Institucioni	Shp 600-609	Investimet 230+231	Totali
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Bashkia	111,177	4,686	115,863
Çështje Financiare dhe Fiskale	Bashkia	57,281	1,200	58,481
Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm	Bashkia	47,550		47,550
Shërbimet e Policisë Vendore	Bashkia	15,563		15,563
Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	Bashkia	48,182		48,182
Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	Bashkia	22,220	7,880	30,100
Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi dhe Mbrojtja e Konsumatoreve	Bashkia	5,405		5,405
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Bashkia	15,197	13,140	28,337
Rrjeti Rrugor Rural	Bashkia		5,607	5,607
Transporti Publik	Bashkia	13,251		13,251
Zhvillimi i Turizmit	Bashkia	12,150	25,496	37,646
Fondi Rezervë	Bashkia	2,000		2,000
Fondi I Kontigjencës	Bashkia	1,000		1,000
Menaxhimi i Mbetjeve	Bashkia	113,378		113,378
Ndërgjegjësimi Mjedisor	Bashkia	2,042		2,042
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	14,571	14,000	28,571
Shërbime Publike Vendore, Mirembajtja e Varrezave Publike dhe Vendore	Bashkia	5,037		5,037
Ndriçim Rrugësh	Bashkia		6,425	6,425
Sport dhe Argëtim	Bashkia	67,712	5,823	73,535
Arsimi Bazë dhe Parashkollor	Bashkia	700	20,000	20,700
Arsim i mesëm i përgjithshëm	Bashkia	130		130
Sigurimi Shoqëror	Bashkia	4,434		4,434



BASHKIA KORÇË

Kujdesi Social për Personat e Sëmurë dhe me Aftësi të Kufizuara	Bashkia	12,196		12,196
Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët	Bashkia	9,119		9,119
Strehimi Social	Bashkia	1,630	4,000	5,630
Total Bashkia		581,925	108,257	690,182
Menaxhimi i Infrastrukturës i Ujitjes dhe Kullimit	NSHP	45,737		45,737
Rrjeti Rrugor Rural	NSHP	6,521		6,521
Sherbime Publike Vendore	NSHP	333,855	12,410	346,265
Ndriçim Rrugësh	NSHP	67,235	4,950	72,185
Total NSHP		453,348	17,360	470,708
Sport dhe Argëtim	KLSH	32,162	480	32,642
Trashëgimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	QAK	75,087	900	75,987
Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor.	NSHMAC	284,652	11,510	296,162
Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	NSHMAC	43,143	4,150	47,293
Arsimi Profesional	NSHMAC	22,524	450	22,974
Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët	NSHMAC	21,780		21,780
Total NSHMAC		372,099	16,110	388,209
Kujdesi Social për Personat e Sëmurë dhe me Aftësi të Kufizuara	QD/QRZH	1,120		1,120
Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët	Shtepia e Foshnjes	4,996	120	5,116
Strehimi Social	NJMBQS	2,454	60	2,514
Total Buxheti		1,523,191	143,287	1,666,478

b) një tabelë përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, sipas zërave kryesorë, për dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tre vitet e ardhshme;

Tabela 7: Përmbledhëse e të ardhurave dhe shpenzimeve (000/lekë)

Të ardhurat	Fakt 2019	Plan 2020 i rishikuar	PI 2021	PI 2022	PI 2023
Të ardhurat nga taksat	308,689	544,855	383,705	516,380	521,544
Të ardhurat nga tarifat	325,663	390,944	413,597	413,360	417,493
Të ardhura nga dhënia me qera	5,175	11,701	8,993	8,876	8,965



BASHKIA KORÇË

Të ardhura nga ndërmarrjet e ndryshme	15,640	15,263	25,173		
Të ardhura të tjera	11,083	24,407	54,000	20,484	20,689
Totali i të ardhurave	666,250	987,170	885,468	959,100	968,691
Të ardhura të kushtëzuara	589,456	570,207			
Për funksionet e deleguara, etj.	10,675	11,192		10,753	10,753
Transferta e pakushtëzuar	439,016	449,034	452,393	463,852	499,328
Transferta e pakushtëzuar sektoriale	307,448	307,780	314,776	314,775	314,775
Transferta specifike mbrojtja civile			13,691		
Të ardhurat e trashëguara	293,882	154,039			
Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	80,601	5,873			
Grande	14,253	5,925	150		
Sponsorizime	1,229	3,884			
TOTALI	2,402,810	2,495,104	1,666,478	1,748,480	1,793,547
Shpenzimet	Fakt 2019	Plan 2020 i rishikuar	PI 2021	PI 2022	PI 2023
600-601	608,099	659,861	712,649	674,041	679,816
602-609, 651, 166	1,158,920	1,429,391	810,542	881,462	883,748
230-231	481,752	405,852	143,287	192,977	229,983
TOTALI	2,248,771	2,495,104	1,666,478	1,748,480	1,793,547

c) numrin e punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për vitin e ardhshëm;

Tabela 8: Numri i punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore, për vitin e ardhshëm

Institucioni	Nr. i punonjësve 2020	Nr. i punonjësve të parashikuar per vitin 2021	Dif
Bashkia Korçë	268	272	4
Shërbimi i MZSH-së	35	35	0
Shërbimi pyjor	28	24	-4
TOTAL BASHKIA	331	331	0
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	343	392	49
Ujitja dhe Kullimi	25	25	0
TOTAL NSHP	368	417	49
Qendra e Artit dhe Kulturës	51	51	0
TOTAL QAK	51	51	0
Klubi Shumësportesh "Skënderbeu"	13	13	0
TOTAL KLUBI SHUMESPORTESH	13	13	0
Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social	2	2	0
TOTAL NJMBQS	2	2	0



BASHKIA KORÇË

Shtëpia e Foshnjës "Lulet e Vogla"	8	8	0
TOTAL SHTEPIA E FOSHNJES	8	8	0
Arsimi parashkollor (transfera specifike)	252	252	0
Arsimi parauniversitar (transfera specifike)	32	32	0
Konviktet e arsimit parauniversitar (transfera specifike)	25	25	0
Çerdhja	25	25	0
NSHMAÇ-NJA	60	60	0
TOTAL NSHMAÇ	394	394	0
Qendra Rezidenciale e Zhvillimit	2	2	0
QKB	2	2	0
GJENDJA CIVILE	12	12	0
TOTAL	1,183	1,232	49

d) *përputhshmërinë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore.*

Buxheti vjetor i Bashkisë Korçë vjen në përputhje me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore, rregulla mbi të cilat është hartuar dhe miratuar edhe paketa fiskale e vitit 2021.

Konkretisht, në gërmën "P", të nenit 54 te ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", në ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ligjin 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", ligjin 8519 date 30.07.1999 "Për ujitjen dhe kullimin", i ndryshuar, ligjin 9385 date 04.05.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative".

7.2. Dokumentacioni shoqërues

a) *Informacion të detajuar për shpenzimet, sipas klasifikimeve buxhetore;*

*Tabela e detajuar për shpenzimet sipas klasifikimeve buxhetore bashkëngjitur materialit të buxhetit 2021, sipas tabelës nr. 5 bashkëngjitur materialit.

b) *Llogaritjen e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore, si pjesë e paketës fiskale të parashikuara në këtë buxhet vjetor po i pasqyrojmë në tabelën e mëposhtme:*

Tabela 9: Llogaritja e efektit financiar të përjashtimeve ose lehtësimeve fiskale vendore

Taksa / tarifa	VLERA/LEKE
Përjashtim nga pagesa e tarifave (pastrim , ndriçim, gjelbërim)	3,133,650
Përjashtim nga pagesa e tarifës së pastrimit për kategorinë "Njësi -Cdo kantier ndërtimi"	850,000
Përjashtim nga pagesa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	10,000,863
Përjashtim nga pagesa e tarifës për zënien e hapësirës publike (muajt Janar, Shkurt dhe Dhjetor)	2,200,000



BASHKIA KORÇË

Lehtësi në pagesën për tarifë vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sitemit kullues	4,605,000
Totali	20,789,513

c) Listën e njësive shpenzuese të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

- Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes
- Klubi Shumësportësh
- Njësia e Menaxhimit të Banesave me Qëllim Social
- Qendra e Artit dhe Kulturës
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
- Qendra Ditore
- Qendra e Zhvillimit Rezidencial
- Shtëpia e Foshnjës

d) Objektivat kryesorë të programeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore:

- a) Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Bashki në mënyrë që ti përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen.
- b) Nxitja e sigurimit të shërbimit cilësor.
- c) Rehabilitimi i infrastrukturës në zonat ku janë parashikuar zhvillime urbane.
- d) Rrugë me cilësi të lartë dhe zhvillim urban me hapësira të reja publike.
- e) Ndërtimi i terminalit të autobuzëve.
- f) Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike.
- g) Shtimi i elementëve plotësues të lulishteve (stola, kosha, vepra arti).
- h) Futja në sisteme efikente alternative të pëdorimit të energjisë.
- i) Përmbushjen me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit.
- j) Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- k) Shtimi i aktiviteteve atraktive sportive.
- l) Parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja në shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore apo të shkaktuara nga dora e njeriut.
- m) Administrimi, qeverisja dhe mbrojtja e fondit pyjor dhe kullësor kombëtar, mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.



BASHKIA KORÇË

- n) Krijimi i marrëdhënieve midis NJQV, pronarëve dhe biznesit privat për administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit pyjor.
- o) Të mbrojtë dhe sigurojë përfituesit nga çdo lloj forme abuzimi.
- p) Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve.
- q) Rehabilitimi dhe rikonstruksioni i veprave ujtitëse.

e) Informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe një analizë të elementeve të riskut, të cilat karakterizojnë këtë borxh;

Intesa Sanpaolo Bank.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Tetor është 49,000,000 lekë.

Për vitin 2014 shuma e disbursuar në muajin Dhjetor është 100,000,000 lekë.

Për vitin 2015 shuma e disbursuar në muajin Mars është 50,000,000 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principli në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 13,299,794.28 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2014-Dhjetor 2020 janë paguar principlial 25,389,001.00 lekë dhe interes në vlerën 11,202,460.00 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principli në vlerën 100,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 26,723,898.01 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Dhjetor 2014-Dhjetor 2020 janë paguar principlial 50,730,278.23 lekë dhe interes në vlerën 22,598,723.89 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principli në vlerën 50,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 12,499,522.17 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Mars 2015-Dhjetor 2020 janë paguar principlial 24,906,512.67 lekë dhe interes në vlerën 10,517,726.74 lekë.

Pro-Credit Bank.

Për vitin 2010 shuma e disbursuar është 44,955,000 lekë.

Për vitin 2011 shuma e disbursuar është 23,776,200 lekë.

Për vitin 2012 shuma e disbursuar është 23,776,200 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë të kredisë është: principli në vlerën 45,000,000 lekë dhe interesi në vlerën 18,373,304.67 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim për periudhën Tetor 2010-Dhjetor 2020 janë paguar principlial në vlerën 44,999,998.68 lekë dhe interes në vlerën 18,373,311.89 lekë. Pra shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e parë (principlial+interes) është shlyer plotësisht.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e dytë të kredisë është: principli në vlerën 23,800,000 lekë dhe interesi në vlerën 9,149,635.21 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Qershor 2011- Dhjetor 2020 janë paguar principlial në vlerën 23,015,692.17 lekë dhe interes në vlerën 9,141,357.83 lekë.

Shuma e shërbimit të borxhit për disbursimin e tretë të kredisë është: principli në vlerën 23,800,000 lekë dhe interesi në vlerën 8,151,243.56 lekë. Sipas planit të pagesave për këtë disbursim Tetor 2012- Dhjetor 2020 janë paguar principlial në vlerën 18,633,703.12 lekë dhe interes në vlerën 7,929,004.12 lekë.

Përdorimi i huamarjes vendore (kredisë) për shpenzime kapitale është mbyllur gjatë vitit 2012.



BASHKIA KORÇË

CEB.

Transhi I 2014-2023 shuma e disbursuar është 340,214 euro

Transhi II 2016-2025 shuma e disbursuar është 640,000 euro

Transhi III 2017-2026 shuma e disbursuar është 110,000 euro

Transhi IV 2018-2027 shuma e disbursuar është 101,386 euro

Sipas planit të pagesave të transhit të parë për periudhën Dhjetor 2014- Nëntor 2020 janë paguar principal në vlerën 27,393,142.64 lekë (204,128.4 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të dytë për periudhën Shtator 2016- Nëntor 2020 janë paguar principal në vlerën 42,099,200 lekë (320,000 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të tretë për periudhën Korrik 2017- Nëntor 2020 janë paguar principal në vlerën 5,665,000.00 lekë (44,000 euro).

Sipas planit të pagesave të transhit të katërt për periudhën Mars 2018- Nëntor 2020 janë paguar principal në vlerën 3,939,859.96 lekë (30,415.80 euro).

Kjo hua është përdorur për ndërtimin e banesave me qëllim social.

Emërtimi i bankës	Principal			Interesi		
	Obligim	Vl. Likujduar	Diferenca	Obligim	Vl. Likujduar	Diferenca
Intesa Sanpaolo Bank	200,000,000.00	101,025,791.90	98,974,208.10	52,523,214.46	44,318,910.63	8,204,303.83
Procredit Bank	92,600,000.00	86,649,393.97	5,950,606.03	35,633,617.44	35,443,673.84	189,943.60
CEB	166,824,000.00	79,097,202.60	87,726,797.40	0.00	0.00	0.00
TOTAL	459,424,000.00	223,235,018.14	236,188,981.86	87,010,903.43	74,987,182.27	12,023,721.16
	Obligim	Vl. Likujduar	Diferenca			
Principal	459,424,000.00	223,235,018.14	236,188,981.86			
Interes	87,010,903.43	74,987,182.27	12,023,721.16			
Total	546,434,903.43	298,222,200.41	248,212,703.02			

Elementët e riskut që e karakterizojnë këtë borxh janë:

- ✓ Ndjekja e grafikut të përgatitur nga bankat me datat përkatëse për likuidimin e kësteve, parashikimi i fondeve për likuidimin e kësteve.
- ✓ Ndryshimi i normave të interesit në rritje.
- ✓ Sigurimi i informacionit të duhur, në kohën e duhur mbi normat e interesit, ndjekja e trendit të normës së interesit.
- ✓ Risku i kursit të këmbimit.
- ✓ Ndjekja me kujdes e raportimit, bisedime me bankën mbi kursin e këmbimit, si dhe ndjekja e



BASHKIA KORÇË

trendit të kursit të këmbimit.

f) një përmbledhje të të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të bashkisë;

Tabela 10: Përmbledhje e të ardhurave, shpenzimeve dhe subvencioneve të shoqërive në pronësi të

bashkisë

(000/lekë)

Subjekti	Të ardhura 2021	Shpenzime 2021			Total shpenzime	Të ardhura - shpenzime
		Shp. për personelin	Shp. të tjera korrente	Shp. për investime		
Korça 2008 sh.a	5,280,000	1,320,834	3,959,166		5,280,000	-
Administrimi I Mbetjeve të Qarkut Korçë sh.a	74,915,710	18,213,907	55,201,803	1,500,000	74,915,710	-
Tregu me shumicë Fruta Perime Korçë sh.a.	17,313,600	7,655,554	8,082,400	400,000	16,137,954	1,175,646
Qendra Sportive Korçë sh.a	68,199,563	12,951,109	48,184,000	4,564,454	65,699,563	2,500,000
UKKO sh.a	400,000,000	117,000,000	228,000,000	50,000,000	395,000,000	5,000,000
TOTAL	565,708,873	157,141,404	343,427,369	56,464,454	557,033,227	8,675,646

8. Buxheti i Bashkisë Korçë për vitin 2021

Shpenzime për personelin 202,919 mijë lekë

Shpenzime korrente 331,456 mijë lekë

Shpenzime për investime 108,257 mijë lekë

Interesi dhe principal 47,550 mijë lekë

Total 690,182 mijë lekë

Buxheti i Bashkisë sipas programeve:

Emërtimi I programit	Institucioni	Shp 600-609	000/lekë	
			Investimet 230+231	Totali
Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	Bashkia	111,177	4,686	115,863
Çështje Financiare dhe Fiskale	Bashkia	57,281	1,200	58,481
Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm	Bashkia	47,550		47,550
Shërbimet e Policisë Vendore	Bashkia	15,563		15,563
Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	Bashkia	48,182		48,182
Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	Bashkia	22,220	7,880	30,100



BASHKIA KORÇË

Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi dhe Mbrojtja e Konsumatoreve	Bashkia	5,405		5,405
Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	Bashkia	15,197	13,140	28,337
Rrjeti Rrugor Rural	Bashkia		5,607	5,607
Transporti Publik	Bashkia	13,251		13,251
Zhvillimi i Turizmit	Bashkia	12,150	25,496	37,646
Fondi Rezervë	Bashkia	2,000		2,000
Fondi I Kontigjencës	Bashkia	1,000		1,000
Menaxhimi i Mbetjeve	Bashkia	113,378		113,378
Ndërgjegjësimi Mjedisor	Bashkia	2,042		2,042
Planifikimi Urban Vendor	Bashkia	14,571	14,000	28,571
Sherbime Publike Vendore, Mirembajtja e Varrezave Publike dhe Vendore	Bashkia	5,037		5,037
Ndriçim Rrugësh	Bashkia		6,425	6,425
Sport dhe Argëtim	Bashkia	67,712	5,823	73,535
Arsimi Bazë dhe Parashkollor	Bashkia	700	20,000	20,700
Arsim i mesem i përgjithshëm	Bashkia	130		130
Sigurimi Shoqëror	Bashkia	4,434		4,434
Kujdesi Social për Personat e Sëmurë dhe me Aftësi të Kufizuara	Bashkia	12,196		12,196
Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët	Bashkia	9,119		9,119
Strehimi Social	Bashkia	1,630	4,000	5,630
Total Bashkia		581,925	108,257	690,182

Detajimi i buxhetit të Bashkisë sipas programeve

8.1. Programi: Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi 01110

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program merret me zhvillimin e njësisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të Kryetarit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore ose të Këshillit. Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin. Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumentave dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësi, zyrave të printimit dhe IT etj. Administrim, funksionim



BASHKIA KORÇË

dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë. Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore. Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit.

Buxheti për këtë program është 115,863 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli 64,625 mijë lekë
- shpenzime korrente 46,552 mijë lekë
- shpenzime për investime 4,686 mijë lekë

000/lekë					
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Transferta tek organizatat	Investime	Total
600	601	602	604	231	
55,425	9,200	39,720	6,832	4,686	115,863

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2021 për këtë program do të jetë në vlerën 55,425 mijë lekë për 83 punonjës, dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ky fond ka një rritje prej 4,998 mijë lekësh ose në masën 10%. Në fondin e planifikuar për paga është llogaritur fond i veçantë në vlerën 363 mijë lekë për shpërblim me rastin e daljes në pension të punonjësve, në rast fatkeqësie etj. Pagat për punonjësit e administratës së Bashkisë, NJA-ve dhe Institucioneve të Varësisë bazohen në VKM nr.177 datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 165 datë 2.3.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar të nëpunësve civilë të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 202 datë 15.3.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.717 datë 23.6.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar si dhe VKM nr. 929 datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, i ndryshuar.

Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 9,200 mijë lekë, dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ky fond ka një rritje prej 700 mijë lekësh ose në masën 8%.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 39,720 mijë lekë krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ky fond ka një ulje prej 9,491 mijë lekësh ose në masën 27%.

Në zbatim të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 71 në buxhetin e vitit 2021 janë planifikuar pagesa e këshilltarëve në vlerën **6,888 mijë lekë** (10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë), si dhe pagesa e kryepleqve të fshatrave të Njësisve Administrative në vlerën **4,200 mijë lekë** (10% e pagesës së Administratorëve të NJA).

Fondi i planifikuar për transfertat për organizatat për këtë program është 6,832 mijë lekë, krahasuar me



BASHKIA KORÇË

planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 18,875 mijë lekësh ose në masën 27% .

1. Kontributi i Bashkisë për UKKO do të jetë në vlerën 5,000 mijë lekë, sipas kontratës me objekt: “Mbështetje financiare për sha Ujësjellës Kanalizime Korçë, nga Bashkia Korçë, data 4.2.2010”
2. Pagesa e komisionit për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël do të jetë në vlerën 42 mijë lekë sipas udhëzimit nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”.
3. Kontributi financiar i Bashkisë për Shoqatën e Bashkive do të jetë në vlerën 1,290 mijë lekë.
4. Kontributi për Qarkut në zbatim të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 38 “Burimet e financimit të Qarkut”, pika 3 ku shprehimisht thuhet: “Qarku financohet nga kuotat e anëtarësisë së Bashkive përbërëse, të përcaktuara në buxhetin vjetor të Bashkive. Kuota e anëtarësisë për financimin e buxhetit të Qarkut përcaktohet me vendim të Këshillit Bashkiak”, si dhe në udhëzimin nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, i ndryshuar, kuota për kontributin e Qarkut do të jetë 500 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 4,686 mijë lekë. Ky fond do të pëdoret për blerje pajisje elektronike (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj), paisje zyre dhe blerje projektor dhe screen projektor për Këshillin Bashkiak.

8.2.Programi: Çështjet Financiare dhe Fiskale 01120

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar, të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Ky program përfshin administrimin e çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, menaxhimin e fondeve të njësisës së vetëqeverisjes etj. Operacionet e thesarit të njësisës, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit. Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Buxheti i këtij programi është në vlerën 58,481 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli 46,856 mijë lekë
- shpenzime korrente 10,425 mijë lekë
- shpenzime për investime 1,200 mijë lekë

000/lekë				
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Shp për investime	Total
600	601	602	231	
40,156	6,700	10,425	1,200	58,481

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2021 për këtë program do të jetë në vlerën 40,156 mijë lekë për 71 punonjës, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,656 mijë lekësh ose 4%.



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 6,700 mijë lekë, pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2020.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë program është në vlerën 10,425 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 1,678 mijë lekësh ose në masën 4%

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për këtë program është në vlerën 1,200 mijë lekë, dhe do të përdoret për krijimin e moduleve për sistemin e menaxhimit të taksave për shërbimet online

8.3. Programi: Pagesa për Shërbimin e Borxhit të Brendshëm 01710

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Ky program përfshin marrëdhëniet e njësisë vendore me kreditorët dhe shërbimin e borxhit të brendshëm të njësisë vendore, pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore, amortizimi i huave të marra etj.

Buxheti i vitit 2021 për kryerjen e pagesave të shërbimit të borxhit do të jetë principli në vlerën **43,850 mijë lekë** dhe interesi në vlerën **3,700 mijë lekë** dhe jepet e detajuar si më poshtë:

Tabela 11: Planet e amortizimit të kredisë (vlerat në 000/lekë)

Emërtimi	Principali	Interesi
ProCredit Bank	3,690	182
Intesa SanPaolo Bank	23,478	3,518
Ministria e Financave (CEB)	16,682	
Total	43,850	3,700

8.4. Programi: Shërbimet e Policisë Vendore 03140

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga tarifat dhe taksat vendore.

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror. Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë. Buxheti i planifikuar për vitin 2021 do të jetë 15,563 dhe i detajuar si më poshtë:

- Shpenzime personeli 12,600 mijë lekë
- Shpenzime korrente 2,963 mijë lekë

000/lekë			
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Total



BASHKIA KORÇË

600	601	602	
10,800	1,800	2,963	15,563

Fondi i planifikuar për paga për punonjësit e policisë bashkiake për vitin 2021 do të jetë në vlerën 10,800 mijë lekë për 21 punonjës nga 13 të planifikuar në vitin 2020, dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 3,336 mijë lekësh.

Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 1,800 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 550 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për shpenzimet operative për këtë program për vitin 2021 janë parashikuar në vlerën 2,963 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 184 mijë lekësh ose në masën 7%.

8.5. Programi: Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile 03280

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar sektoriale, transferta specifike dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

Ky program merret me garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimin e strukturave përkatëse, si dhe me parandalimin, mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor. Ky shërbim për vitin 2021 do të ketë një buxhet prej **48,182 mijë lekësh** dhe do të funksionojë me një staf prej 35 punonjësish. Transferta e pakushtëzuar sektoriale ka një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2020. Detajimi i buxhetit jepet si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 29,049 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 19,133 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga do të jetë në vlerën 24,849 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 2,049 mijë për shkak të rritjes së numrit të punonjësve për vitin 2021.

Fondi i planifikuar për zërin sigurime shoqërore dhe shëndetësore do të jetë në vlerën 4,200 mijë lekë.

Shpenzimet operative janë parashikuar në vlerën 2,442 mijë lekë, nga të cilat 915 mijë lekë nga transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe 1,527 mijë lekë nga të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Transferta tek individët	Totali
600	601	602	606	
24,849	4,200	2,442	16,691	48,182

Në buxhetin e këtij programi është përfshirë dhe **fondi për mbrojtjen civile (emergjencat civile)**, të planifikuara në llogarinë 606 (transferta tek individët), të cilat për vitin 2021 janë planifikuar në vlerën 16,691 mijë lekë, nga të cilat 13,691 mijë lekë nga transferta specifike dhe 3,000 mijë lekë nga të ardhurat nga taksat



BASHKIA KORÇË

dhe tarifat vendore. Në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 65.

Përdorimi i këtij fondi do të bëhet sipas udhëzimeve të përcaktuara nga MFE dhe Ministria e Mbrojtjes dhe kryesisht për parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, duke përfshirë edhe dëmshpërblimin e familjeve, banesat e të cilëve dëmtohen nga fatkeqësi të ndryshme, në zbatim të ligjit 8756 dt. 26.03.2002 “Për emergjencat civile” neni 16, pika 2, gërma ç).

Të ardhurat që do të realizohen gjatë vitit 2021 nga ky shërbim do të jenë në vlerën 540 mijë lekë.

8.6. Programi: Mbështetja për Zhvillimin Ekonomik 04130

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Në këtë program përfshihet mbështetja dhe promovimi i bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda territorit të njësisë vendore. Buxheti i planifikuar për programin mbështetja për zhvillimin ekonomik është 30,101 mijë lekë si më poshtë:

-shpenzime korrente 22,221 mijë lekë

-shpenzime për investime 7,880 mijë lekë

000/lekë			
Shp operative	Transferta tek organizatat	Investime	Totali
602	604	231	
3,008	19,213	7,880	30,101

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 3,008 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,113 mijë lekësh.

Fondi i planifikuar në zërin transferta tek organizatat do të jetë në vlerën 19,213 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,069 mijë lekësh.

Ky fond është planifikuar transfertë për BID, TID dhe kontributi I Bashkise per projektin inovacion. Të detajuara jepen përgjatë materialit.

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime do të jetë në vlerën 7,880 mijë lekë. Ky fond është planifikuar si kontributi I Bashkise Korce per realizimin e projektit Tregu i gjësë së gjallë.

8.7. Programi: Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve 04220

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore.

Në këtë program përfshihet administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve. Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të grandeve për bujqësinë e zhvillimit rural, kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit. Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinare për blegtorinë.

Buxheti i planifikuar për këtë program është në vlerën 5,405 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 5,370 mijë lekë



BASHKIA KORÇË

- shpenzime korrente në vlerën 35 mijë lekë

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Totali
600	601	602	
4,600	770	35	5,405

Fondi i planifikuar për paga për këtë program është në vlerën 4,600 mijë lekë për 9 punonjës nga 3 të planifikuar në vitin 2020 dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,030 mijë lekësh.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 770 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 175 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për shpenzimeve operative është në vlerën 35 mijë lekë krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 6 mijë lekësh.

8.8. Programi: Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave 04260

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar sektoriale dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore.

Në këtë program përfshihen fondet nga funksioni i transferuar që nga viti 2016 i administrimit të pyjeve. Ky funksion merret me administrimin e çështjeve dhe shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, mbikqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore dhe dhënia e licensave për prerje pemësh. Gjithashtu ky shërbim merret me shpërndarjen e kullotave, duke përfshirë menaxhimin e kullotjes. Transferta e pakushtëzuar sektoriale e vitit 2021 ka një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2020. Buxheti i këtij program është në vlerën 28,337 mijë lekë, nga të cilat 15,197 mijë lekë nga transferata e pakushtëzuar sektoriale dhe 13,140 mijë lekë nga të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 12,983 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 2,214 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 13,140 mijë lekë

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Investime	Totali
600	601	602	231	
11,133	1,850	2,214	13,140	28,337

Fondi i planifikuar për paga në këtë program për vitin 2021 është në vlerën 11,133 mijë lekë për 24 punonjës nga 22 punonjës të planifikuar në vitin 2020 dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,876 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për këtë program për vitin 2021 është në vlerën 1,850 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për vitin 2021 është në vlerën 2,214 mijë lekë dhe



BASHKIA KORÇË

krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 701 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për shpenzime për investime për vitin 2021 është në vlerën 13,140 mijë lekë.

8.9. Programi: Rrjeti Rrugor Rural 04520

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

Në këtë program përfshihet ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësitë e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

Buxheti i këtij program është në vlerën 5,607 mijë lekë dhe do të përdoret për investime. Kjo vlerë është financimi i vitit 2021 për objektin “Rikonstruksioni i rrugës Koço Glozheni fshati Dardhë”, i cili u miratua me 2 vite buxhetore me vlerë kontrate 10,607,197 lekë, nga të cilat 5,000,000 lekë të planifikuara në vitin 2020.

8.10. Programi: Transporti Publik 04570

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

Ky program përfshin kontraktimin e shoqërive private të transportit për sigurimin e shërbimeve të transportit publik lokal, apo grante, hua ose financime për të mbështetur funksionimin, ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e sistemeve dhe strukturave të transportit publik lokal.

Buxheti i këtij program është në vlerën 13,251 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime për personelin në vlerën 525 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 12,727 mijë lekë

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Subvencione	Transferta tek organizatat	Totali
600	601	602	603	604	
450	75	201	10,000	2,525	13,251

Fondi i planifikuar për paga për supervizorin e transportit publik urban është 450 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për supervizorin e transportit publik urban është 75 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për transportin publik urban është 201 mijë lekë, i cili krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 64 mijë lekësh.



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për subvencionin e shërbimit të transportit qytetës.

Ky shërbim kryhet nga shoqëria “Ortakëria Korca” sh.p.k, e cila subvencionohet duke u bazuar në kontratën e lidhur me këtë shoqëri, e cila përfundon më qershor 2023. Në buxhetin e vitit 2021, ky shërbim planifikohet në vlerën **10,000 mijë lekë**. Ky shërbim mbështetet në realizimin e zërave të mëposhtëm:

1.Itenerari I mjeteve te percaktuar në kontrate

a) Linja Bankë : Nisja në lindje të rrethrotullimit të varrezave publike, kryqëzimi I rrugëve “Kristaq Sotiri”, “Asim Vokshi”, Kryqëzimi I rrugëve “Sotir Polena”, “Asim Vokshi”, “Birra Korca”, Spitali, busti Naum Veqilharxhi, përballë poliklinikës, Pazari, BKT, Lëndina e lotëve, Universiteti, Parku Sigurimet Shoqerore, UKKO, përballë DPM , nënstacioni, përballë kryqëzimit të Rr. “Pano Xhamballo”, me unazën , City Center, pazari , poliklinika, posta 1, Shkolla “Demokracia”.

b) Linja Unazë : Nisja në lindje të rrethrotullimit të varrezave publike, kryqëzimi I rrugëve “Kristaq Sotiri”, “Asim Vokshi” Kryqëzimi I rrugëve “Sotir Polena”, “Asim Vokshi”, Birra Korça, Spitali busti Naum Veqilharxhi, përballë poliklinikës, Pazari, City Center, Kryqëzimi Rr “Pano Xhamballo”, Shkolla e Maltës , Parku, Sigurimet Shoqërore, UKKO, Përballë DPM, Rr “ Niko Kovaci”, Lëndina e Lotëve, stacioni Bul.GJ.Kastrioti, Pazari, Poliklinika, Posta 1, Shkolla Demokracia.

c) Linja Medrese-SMT: Nisja Shkolla “Demokracia” ish Formula 1, Medrese, Dyqanet e Gurta, Pazari, City Center, Fabrika “Tona Co”, stacioni Çiflik (me orar të reduktuar), ish frigoriferi, përballë City Center, Pazar, përballë Dyqaneve të Gurta, përballë Medresesë, pranë kryqëzimit me Rr: “10 Korriku”.

d) Linja Korçë-Dishnicë-Neviçisht-Kuç: Nisja Tregu Maqedonas-Unazë, Rr e Barçit, Dogana, Dishnicë (qendër), Neviçisht (hyrje), Belorta (hyrje), Kuç (hyrje), Belorta, Dogana, Tregu Maqedonas.

2.Orari i shërbimit të këtij transporti.

a) Linja Bankë, orari 06:00-20:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-18:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

b) Linja Unazë, orari 06:00-20:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-18:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

c) Linja Medrese-SMT, orari 06:45-18:00 për periudhën 1 Prill-30 Shtator

orari 06:00-16:00 për periudhën 1 Tetor-31 Mars

d) Linja Korçë-Dishnicë-Neviçisht-Kuç, orari 07:00-15:00 gjatë gjithë vitit

3.Numri i mjeteve në linjë.

Në linjën Bankë 2 mjete

Në linjën Unazë 2 mjete

Në linjën Medrese-SMT 2 mjete

Në linjën Korçë-Dishnicë 1 mjet



BASHKIA KORÇË

4.Frekuenca

Linja Bankë-frekuenca çdo 22 minuta

Linja Unazë-frekuenca çdo 23 minuta

Linja Medres-frekuenca çdo 20 minuta

Linja Korçë-Dishnicë-frekuenca çdo 1 orë

5.Qëndrimi i mjeteve nëpër stacionet e përcaktuara.

Subjekti "Ortakëria" zbaton dhe pikën 12 të nenit 7 të kontratës mbi udhëtimin falas të moshës së tretë.

Transferta tek organizatat është planifikuar dhe kontributi i Bashkisë për mirëmbajtjen e sistemit rrugor "transporti inteligjent" në vlerën 2,525 mijë lekë.

8.11.Programi: Zhvillimi i Turizmit 04760

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore.

Ky program merret me nxitjen e projekteve zhvillimore që kanë për qëllim rritjen ekonomike e turizmin në njësinë e vetëqëverisjes vendore, si dhe zhvillimin dhe promovimin e turizmit.

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 është në vlerën 37,646 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- Shpenzime personeli në vlerën 560 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerë 11,590 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerë 25,496 mijë lekë

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoq dhe shëndet	Shp operative	Investime	Totali
600	601	602	231	
480	80	11,590	25,496	37,646

Fondi i planifikuar për paga në këtë program për vitin 2021 është në vlerën 480 mijë lekë për 1 punonjës dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 843 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për këtë program për vitin 2021 është në vlerën 80 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative si dhe për realizimin e projekteve për zhvillimin e turizmit është në vlerën 11,590 mijë lekë nga të cilat 2,347 mijë lekë janë shpenzime për projektet IPA.

Fondi i planifikuar për investime është në vlerën 25,496 mijë lekë nga të cilat 25,286 mijë lekë janë për projektet IPA.



BASHKIA KORÇË

Detajimi i projekteve

Titulli i Projektit: Festa e Birrës

Kohëzgjatja: 11-15 Gusht 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festa e birrës në Korçë është event i madh veror festiv në Shqipëri. Mbi 100 000 persona vizitojnë festën e birrës në 5 netët e organizimit të saj. Kryesisht numri i madh i vizitorëve në festë i atribuohet principeve kryesore të organizimit të festës:

- Hyrje falas
- Program muzikor i shkëlqyer me emrat më të njohura të muzikës shqiptare dhe të huaj
- Pjesëmarrje e një game birrash vendase dhe të huaja

Festa e birrës në Korçë u themelua në vitin 2007, si një iniciativë e Bashkisë Korçë. Festivali është nderuar me çmimin e Turizmit nga Ministria e Kulturës në vitin 2010, për shkak të influencës që pati në rritjen e numrit të turistëve në rajon. Festa e birrës në Korçë, jo vetëm është një segment i rëndësishëm përse i përket tërheqjes së vizitorëve në rajon, por nga viti në vit ka promovuar dhe përforcuar imazhin turistik të rajonit. Festa e birrës do të zhvillohet në datat 11-15 Gusht 2021 në dy zona; tek fusha pranë stadiumit "Skënderbeu" dhe tek Pazari i vjetër, Korçë. Një dekor i personalizuar tek te dyja vendet do të krijojë një atmosferë shumë të bukur festive, duke rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve në qytet si dhe ndikuar pozitivisht në rritjen e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor.

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Shtimi i numrit të bizneseve pjesëmarrëse në festë
- Rritja e cilësisë së shoë-ut dhe krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme për vendndodhjen e festës
- Rritje të impaktit direkt dhe indirekt në rritjen e të ardhurave të bizneseve të rajonit e më gjerë.

Përfituesit/ Treguesit

- Mbi 15,000 vizitorë në natë, gjatë të pesta netëve
- Mbi 50 biznese pjesëmarrëse dhe bashkë organizues në festën e birrës
- Mbi 50 këngëtarë dhe grupe artistike që performojnë në të dyja skenat e festës së birrës.
- Të gjithë qytetarët e Korçës dhe rajonit janë pjesëmarrës gjatë festës së birrës
- Fëmijët përmes këndit të lojrave të vendosur gjatë festës së birrës.
- Bizneset lokale (Hotele/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen ekonomike

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Hartimi i planit të punës dhe marketingut
- Kontakte me donatorë të ndryshëm dhe pjesëmarrës potencialë
- Realizimi i Dekorit Festiv në dy zonat ku do të zhvillohet festa (Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit)



BASHKIA KORÇË

- Realizimi i materialeve promocionale (fletëpalosje, citylight, baner, bluza pambuku me logon zyrtare të festës, çanta beze me logon e festës, bexhe për stafin organizator etj)

- Menaxhimi i eventit
- Promovimi i eventit
- Realizimi i festës së birrës

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Viti 2021 shënon 14 vite histori të festës së Birrës, një festë që gjithmonë ka shënuar rritje të cilësisë së vet. Risi e këtij viti do të jetë dekori festiv i veçantë në të dy zonat si dhe rritje cilësore të gjithë komponentëve të shoë-t artistik, që do të na shoqërojë përgjatë 5 netëve të festës së birrës.

Rezultate:

- Rritje të numrit të vizitorëve
- Promovimi qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 3,335,500 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me bizneset pjesëmarrëse të interesuara për t'u promovuar si dhe në bashkëpunim me nje organizatë/partner zbatues.

Titulli i projektit : “Pjesëmarrje në Panaire Kombëtare dhe Ndërkombëtare”

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Për Bashkinë e Korçës turizmi është një nga prioritetet kryesore zhvillimore, jo vetëm bazuar te resurset natyrore, trashëgimninë e pasur kulturore dhe historike, por edhe tek projektet tona të shumta në këtë drejtim, investime, festa dhe aktivitete të larmishëm përgjatë gjithë vitit për të tërhequr sa më shumë vizitorë vendas dhe te huaj duke e parë këtë potencial si burim për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Gjatë vitit 2021 Bashkia Korçë do të marrë pjesë në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, që mund të organizohen nga institucione publike dhe private në Shqipëri ose jashtë saj dhe që kanë në fokus promovimin e vlerave turistike të vendeve pjesëmarrëse. Pjesëmarrja e Bashkisë Korçë në aktivitete të tilla, rrit numrin e vizitorëve dhe investitorëve, si edhe krijon kontakte me investitorë të huaj, agjensi turistike me të cilët Bashkia Korçë bashkëpunon në të ardhmen.

Qëllimi: Promovimi i vlerave turistike dhe agroturistike të Korçës, të cilat ndikojnë në zhvillimin rajonal të zonës.

Rritje të bashkëpunimit me agjensi turistike

Objektivat:

- 1.Zhvillimin e mëtejshem të partneritetit publiko-privat, me synim përmiresimin e jetesës së qytetarëve si dhe nxitjen e investimeve në qytet me fokus turizmin
2. Gjallërimin e bizneseve vendase dhe të huaja.
- 3.Prezantimin e mundësive dhe ideve për zhvillimin e turizmit në qytetin e Korçës.



BASHKIA KORÇË

Përfituesit/ Treguesit:

- mbi 20 individë sipërmarrës (50% femra, 50 % meshkuj), pjesmarrës në panairë në nivel kombëtar
- mbi 50 biznese pjesmarrëse në panairë në nivel kombëtar

Programi i Aktiviteteve:

- Hartimi i një plani strategjik për turizmin
- Kontakte të vazhdueshme me agjensi turistike
- Evidentimi i datave të panairëve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e turizmit
- Hartimi i materialeve promocionale (guide e qytetit, kalendar eventesh (shqip dhe anglisht) baner për brandim stende)
- Pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Promovimi i qytetit të Korçës në nivel ndërkombëtar përmes hartimit të paketave turistike në bashkëpunim të përhershëm me agjensitë turistike.

Rezultatet:

1. Prezantimi i qytetit të Korçës si një destinacion turistik.
2. Nxitja e investimeve në qytet dhe rritja e mundësisë për të investuar në Korçë.
3. Prezantimi i ideve të bashkisë Korçë për zhvillimin e partneritetit publiko-privat.
4. Tërheqja e investitorëve dhe turistëve vendas dhe të huaj

Kostoja totale: 300,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

Titulli i projektit: Festa e Mollës

Kohëzgjatja: Shtator- Tetor 2021

Përshkrim i përgjithshëm i projektit

“Festa e mollës” tashmë një festë e kthyer në traditë, e organizuar për të disatin vit radhazi nga Bashkia Korçë, në zonën e Dvoranit, zonë e njohur për prodhimin e mollës, do të konsistojë në aktivitet të pasur ku do të ndërthurret tradicionalja me prodhimet vendase dhe moderne. Në këtë aktivitet do të jenë të pranishëm biznese që merren me grumbullimin dhe përpunimin e produkteve agro, fermerë të zonës si dhe qytetarë, të cilët do të shijojnë prodhimet e rajonit të Korçës. Bizneset dhe fermerët do të prezantojnë produktet e tyre, do të hapin dyert për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj për të qënë pjesë e vjeljes së mollëve tek fermat e tyre. Vizita në fermë, takim me bizneset dhe fermerët, panair me baze frutin e mollës dhe produkte të tjera kulinarie të gatuar dhe përgatitura nga amvisat e këtij vendi si petulla me mollë, reçel molle, prevede etj. Duke besuar në suksesin e këtij projekti, synojmë përsëritjen e tij çdo vit duke e pasuruar gjithnjë me të tjerë elemente.

Qëllimi: Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

Objektiva:

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë



BASHKIA KORÇË

Përfituesit / Treguesit

- 20 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së mollës
- Festa e Mollës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të grave pjesëmarrëse në festë
- Bizneset e zonës
- mbi 30 fermerë të zonës të cilët promovojnë dhe tregëtojnë varietete e ndryshme të mollës
- mbi 500 vizitorët (qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat kulturore të Dvoranit.
- Fëmijët pjesëmarrës në vjeljen e mollëve si dhe në aktivitetet argëtuese dhe çlodhëse.

Programi i Aktiviteteve:

- Mbledhja e mollëve në një nga Fermat e Dvoranit
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (*Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara proçedurës së prokurimit).*
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Festë
- Koncert festiv
- Panairi i molleve, në bashkëpunim me bizneset grumbulluese dhe përpunuese të produkteve agro si dhe fermerët e rajonit do të zhvillohet panairi i produkteve agro, duke promovuar kështu produktet e zonës së Korçës. Pjesë e panairit do të jenë edhe gatimet e shumta me bazë mollët, të cilat do të reklamohen nga amvisat e kësaj zone
- Realizmi i materialeve promocionale (çanta letre të riciklueshme për mbledhjen e mollëve, kapela dhe përparëse, fletpalosje, baner etj)
- Aktivitete për fëmijë (kënd i dedikuar fëmijëve me aktivitete të ndryshme edukative dhe argëtuese)
- Promovimi i eventit
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës së mollës

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Festa e Mollës organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të bizneseve agropërpunuese pjesëmarrëse. Aktiviteti Festa e Mollës është një aktivitet tepër interesant, të cilin synojmë ta kthejmë në një aktivitet që tërheq vëmendjen e shumë vizitorëve vendas dhe të huaj, të cilët vizitojnë për here të pare Korçën.

Rezultate:

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 258,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës



BASHKIA KORÇË

Shënime: Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me bizneset pjesmarrëse në panairin e mollëve.

Titulli i projektit: Festa e Voskopojës

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Voskopoja, një qendër kulturore dhe historike e rëndësishme e cila po kthehet në fshatin turistik model në Shqipëri. Festa e Voskopojës krijon një atmosferë tepër të veçantë në Voskopojë, e cila tregon më të mirën që ofron ky atraksion turistik, duke nisur nga trashëgimia kulturore, legjendat e banorëve, historia, prodhimet tradicionale, aktivitetet sportive, e për t'u mbyllur me një koncert me muzikë live. Voskopoja mbetet gjithmonë atraksioni më i preferuar dhe më tërheqës për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj.

Qëllimi: Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.

Objektiva:

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

Përfituesit/ Treguesit

- 35 gra/ amvisa të cilat përfshihen direkt në organizimin dhe zhvillimin e festës së Voskopojës duke përgatitur panairin e kulinarisë, produktet tipike si dhe produktet e artizanatit.
- Festa e Voskopojës ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke synuar dhe iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale , pjesëmarrës në festë
- 20 bizneset e zonës
- mbi 1000 vizitorët (qytetarë vendas dhe të huaj), të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Voskopojës, sidomos gjatë fundjave.

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (Dekor i Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose druri të ndriçuara, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit).
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Panair
- Koncert festiv
- Panairi i produkteve kulinare në bashkëpunim me bizneset e zonës
- Realizmi i materialeve promocionale
- Promovim e eventit
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i aktivitetit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Festa e Voskopojës organizohet për të katërtin vit radhazi, synojmë që këtë vit këtë festë ta kthejmë në një magnet për tërheqjen e sa më shumë vizitorëve.

Rezultate:



BASHKIA KORÇË

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforcim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 490,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me bizneset pjesmarrëse në panairin e kulinarisë.

Titulli i projektit: Festa e Rakisë

Kohëzgjatja: Gusht/Shator 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Boboshtica është një nga fshatrat më të famshëm në rajon për turizmin kulinar e që vizionohet nga të gjithë ne si destinacioni i shijes. Produkti karakteristik i Boboshticës është Rakia e Manit të Zi dhe degustimi në zonën Boboshticë-Drenovë. Kjo pije alkoolike, e prodhuar nga fruta të ndryshme, ka krijuar emrin e vet edhe në fshatra të tjerë: Dardha dallohet për rakinë e famshme të kumbullës së egër të zier dy herë, Voskopoja dallohet për rakinë e prodhuar nga thana, Polena, është kthyer sot në punishten artizanale të rajonit për prodhimin e rakisë së rrushit, ndërsa Dvorani, nisur nga plantacionet e famshme të mollëve mbart potencial për të prodhuar rakinë e mollës, duke mundësuar kështu një diversifikim të nënprodukteve e duke iu bashkuar itinerarit rajonal të shijes.

Qëllimi:

Qëllimi i organizimit të këtij projekti është nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit nëpërmjet aktiviteteve të cilat synojmë të tërheqim numër të madh vendasish dhe të huaj.

Objektiva:

- Promovimi i produkteve të rajonit
- Rritja e numrit të frekuentimit të zonave përreth Korçës.
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Zhvillimi i ekonomisë lokale tek kjo zonë

Përfituesit /Treguesit

- 30 % e komunitetit (femra dhe meshkuj) pjesmarrës aktivë në organizimin e Festës së Rakisë
- mbi 10% e grave pjesmarrëse në panairin e kulinarisë që do të realizohet gjatë festës, me qëllim promovimin dhe tregëtimin e produkteve tipike
- 10 % e bizneseve të zonës
- Fermerët e zonës
- rreth 300 vizitorë pjesmarrës në Festën e Rakisë

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës që do të realizojë Festën e Rakisë
- Dekor i veçantë tek sheshi ku do të zhvillohet Festa (Dekori Festiv i parashikuar si zë në buxhetin e festës do të përdoret për krijimin e elementëve të ndryshëm dekorativë si elementë ndriçimi, struktura metalike ose



BASHKIA KORÇË

druri të ndriçuar, printime në forex etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit)

- Vizitë tek familjet ne Boboshticë për të parë nga afër si prodhohet Rakia e Manit
- Markimi i bizneseve të cilat do të marrin pjesë në Festën e Rakisë
- Koncert festiv me serenata
- Panairi i produkteve tipike korçare, duke synuar promovimin e produkteve të zonës së Korçës.
- Realizmi i materialeve promocionale (çanta letre të riciklueshme për mbledhjen e mollëve, kapela dhe përparëse, fletpalosje, baner etj. Grupi i punës specifikon detajet e dekorit festiv 45 ditë përpara procedurës së prokurimit)
- Promovim e eventit në media dhe në rrjetet sociale
- Menaxhimi i eventit
- Realizmi i festës së rakisë

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Festa e Rakisë organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të numrit të vizitorëve që frekuentojnë festën, risi e këtij viti do të jetë promovimi i itinerarit të shijes.

Rezultate:

- Rritje të numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Promovimi i produkteve tipike lokale
- Impakt direkt në rritjen e zhvillimit ekonomik
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore
- Përforsim i imazhit turistik të vendit

Kostoja Totale: 273,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: Projekti do të implementohet nga Bashkia Korçë në bashkëpunim me banorët e Boboshticës.

Titulli i projektit: Festa e Vithkuqit

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia e qytetit të Korçës do të risjellë këtë vit eventin “Festa e Vithkuqit” me synimin për të rivitalizuar promovimin e potencialeve turistike, vlerave që ka zona, traditën dhe trashëgiminë kulturore. Kjo festë përfshin një numër të gjërë aktivitetesh si; koncert festiv, panair kulinarie, aktivitete për fëmijë, etj.

Qëllimi:

Promovimi i vlerave të artit të gastronomisë, nxitja si një destinacion turistik përmes promovimit të vlerave tradicionale të zonës.

Objektiva:

- Nxitja dhe promovimi i produkteve të zonës nëpërmjet aktiviteteve për të tërhequr numër të madh turistësh
- Promovim i traditës dhe vlerave artizanale, kulinarisë të fshatit, si dhe pasurisë folklorike dhe kulturore
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar mbas kulturave dhe traditave
- Gjallërimin dhe promovimin e bizneseve të fshatit
- Tërheqja e investitorëve për të shtuar numrin e bizneseve në fshat



BASHKIA KORÇË

Përfituesit/ Treguesit

- 25 % e komunitetit (femra dhe meshkuj) pjesmarrës aktivë në organizimin e Festës së Vithkuqit
- mbi 10% e grave pjesmarrëse në panairin e kulinarisë dhe artizanatit që do të realizohet gjatë festës lokale, me qëllim promovimin dhe tregëtimin e produkteve tipike
- Bizneset e zonës
- rreth 250 vizitorë pjesmarrës në festë

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakt me pjesëmarrësit në bashkëpunim
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera set, tavolina, stola, aparate dhe pajisje teknike, makineri etj)
- Realizimi i materialeve promocionale (dizenjim dhe realizim fletëpalosjesh turistike për promovimin e Vithkuqit , baner)
- Realizimi i transportit (transporti i pjesëmarrësve vajtje-ardhje)
- Njoftimi i qytetarëve
- Kontakti dhe përgatitja
- Kontakti me bizneset dhe donatorët
- Promovim dhe marketing
- Realizimi i eventit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Për të disatin vit rradhazi “Festa e Vithkuqit” zhvillohet dhe çdo vit e më shumë vihet re një pjesëmarrje më e lartë e qytetarëve, por edhe e vizitorëve që frekuentojnë këtë aktivitet.

Rezultate:

- Gjallërimi i jetës artistike dhe kulturore në fshatin e Vithkuqit
- Rritja e numrit të vizitorëve nga brenda dhe jashtë vendit
- Promovim i produkteve të rajonit
- Promovimi i zonave të fshatit dhe atraksioneve turistike

Kostoja Totale: 351,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: Kjo festë zhvillohet në fshatin turistik të Vithkuqit.

Titulli i projektit: Festa e Lakrorit

Kohëzgjatja: Fund Korriku- fillim Gushti 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia e qytetit të Korçës sjell traditën e përvitshme me aktivitetin “Festa e Lakrorit”, e cila ka qëllim gjallërimin e jetës së qytetit si dhe rizgjimimin dhe promovimin e vlerave të qytetit, duke e bërë atë sa më atraktiv për turistët vendas dhe të huaj. Festa e lakrorit njihet si një nga festat me tradicionale të qytetit ku ndërthur gatimin tradicional, lojrat dhe elementë të tjerë të cilat krijojnë një atmosferë argetuese në qytetin e Korçës për të tërhequr turistë brenda dhe jashtë vendit dhe duke e kthyer atë e në një pikë atraktive për turistët.

Qëllimi:



BASHKIA KORÇË

Promovimi i vlerave tradicionale të artit të gastronomisë dhe nxitja dhe promovimi i produkteve të rajonit, nëpërmjet aktiviteteve të cilat tërheqin numër të madh vendasish dhe të huaj.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve
- Rritja e të ardhurave të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (Bare, restorante, hotele etj)
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Trashëgimia e kulturës dhe traditës korçare në vitet e ardhshme
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dherrethinave .
 - Me qëllim gjallërimit të jetës së qytetit si dhe rizgjim dhe promovimin e vlerave të qytetit

Përfituesit / Treguesit

- 30 gra/ amvisa, të cilat angazhohen direkt së bashku me familjet e tyre në organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit, duke përgatitur lakrorin në saç.
- Festa e lakrorit ndikon pozitivisht në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të zonës duke iniciuar krijimin e sipërmarrjeve individuale të 30 grave pjesëmarrëse në festë.
- 10 bizneset e zonës
- Rreth 2000 vizitorë (qytetarë vendas dhe të huaj) të cilët shijojnë jo vetëm traditën e kulinarisë por dhe vlerat kulturore të Polenës.

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakti me pjesëmarrësit për bashkëpunim
- Identifikimi i vendit më të përshtatshëm
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera aparate, pajisje teknike ,makineri, tavolina, stola, saçe)
- Realizimi i materialeve promicionale (bluza, kapele, përparëse, baner, fletëpalosje)
- Realizimi i transportit (vajtje- ardhje) dhe shpenzime të tjera (materiale për prodhimin e lakrorit)
- Njoftimi i qytetarëve
- Kontakti dhe përgatitja
- Kontakti me biznese dhe donatorë
- Promovim dhe marketing
- Realizimi i aktivitetit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Për më shumë se 10 vite rradhazi “Festa e Lakrorit”, tashmë është kthyer në një traditë, që ka si synim rritjen e numrit të pjesëmarrësve.

Rezultate:

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i produkteve të Rajonit
- Promovim i vlerave kulturore
- Rritja e numrit të rinjve si frekuentues të aktiviteteve të organizuara nga bashkia

Kostoja Totale: 491,560 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe



BASHKIA KORÇË

Diasporës

Shënime: Festa e Lakrorit zhvillohet në fshatin e Polenës.

Titulli i projektit: Vizito Korçën

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Korça, e njohur për serenatat, traditën e kulturën, mbetet padyshim destinacioni kryesor i turistëve venda dhe të huaj për të kaluar momente të bukura në çdo kohë. Një udhëtim në Korçë për një fundjavë apo edhe disa ditë më shumë, do të ishte zgjedhja e duhur në të gjitha stinët e vitit. Me qëllim promovimin e qytetit dhe destinacioneve turistike rreth Korçës, por edhe pasurimin e materialeve promovuese, Bashkia Korçë do të realizojë një guide turistike dy gjuhëshe si edhe disa fletëpalosje/ broshura, të cilat do ju vijnë në ndihmë të gjithë vizitorëve, që vizitojnë Korçën

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit përmes promovimit të vlerave kulturore dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore, përmes realizimit të materialeve të nevojshme promocionale.

Objektiva:

- Promovimi kombëtar dhe ndërkombëtar i Korçës si destinacion i veçantë turistik
- Pasurimi dhe përditësimi i informacionit për materialet promocionale
- Informimi i vizitorëve vendas dhe të huaj për vlerat turistike, artistike, kulturore, që ka Korça.

Përfituesit / Treguesit:

- Vizitorët vendas dhe të huaj që vizitojnë qytetin
- Strukturat akomoduese (Hotele, bujtina, guest house)
- Zyra e Informacionit Turistik në Korçë
- Vizitorë apo qytetarë nga vende të ndryshme të Shqipërisë, që frekuentojnë panaire apo aktivitete turistike të organizuara gjatë vitit.

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Mbledhja e materialeve të nevojshme rreth atraksioneve turistike (përshkrime dhe foto)
- Përzgjedhja me kujdes e materialeve që do të publikohen në guidë, fletpalosje, broshura.
- Kontakte të vazhdueshme me subjektin që do të realizojë dizajnimin e materialeve
- Konfirmimi me grupin e punës i formatit që do të kenë materialet
- Realizimi i materialeve
- Përgatitja e një plani shpërndarje të materialeve

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Bashkia Korçë gjatë viteve të kaluara ka realizuar guida turistike dhe broshura promovuese të Korçës, të cilat ju janë shpërndarë vizitorëve vendas dhe të huaj që vizitojnë Korçën, por edhe kanë prezantuar Korçën në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare. Për arsye të përfundimit të sasisë së materialeve promocionale, por gjithashtu edhe për arsye të nevojës që lind për përditësim të informacionit, është e nevojshme realizimi i materialeve promocionale përgjatë çdo viti. Risi përbën publikimi i informacioneve të përditësura, të cilat mungojnë në broshurat dhe guidat e mëparshme.

Rezultate:

- Pasurimi i materialeve, që marketojnë Korçën dhe destinacionet turistike përreth saj.



BASHKIA KORÇË

- Realizimi i materialeve të nevojshme promocionale, të cilat do të shpërndahen falas për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj (guide e qytetit dy gjuhëshe, fletëpalosje me informacion turistik për destinacionet turistike Dardhë, Vithkuq).

- Informacion i përditësuar rreth atraksioneve të shtuara në Bashkinë e Korçës.

Kostoja totale: 1,080,600 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Titulli i projektit: Festivali i Vjeshtës

Kohëzgjatja: Shtator – Tetor 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Festivali i vjeshtës një tjetër event që i bashkohet qytetit të Korçës gjatë periudhës së vjeshtës i cili konsiston një numër të madh aktivitetesh kulturore, artistike dhe tradicionale për të përçuar vlerat që ky qytet mbart . Përveç dekorit specifik dhe të personalizuar me mjeshtëri nga stafi i Bashkisë, veçantia e këtij festivali do të shoqërohet dhe me praninë e këngëtarëve të mirënjohur të cilët do të performojnë në skenat e Pazarit të Vjetër dhe në zonën kryesore të qytetit.

Qëllimi:

Vazhdimësia dhe kthimi i këtij eventi në një traditë kulturore për qytetin e Korçës.

Objektiva:

1. Gjallërimi dhe pasurimi i jetës social-kulturore në qytet
2. Promovimi i qytetit si një atraksion turistik i mbushur me aktivitete kulturore
3. Frekuentimi dhe rritja e të ardhurave të bizneseve që lidhen direkt/indirekt me turizmin (bare, restorante, hotele etj)
4. Synimi për të rritur numrin e turistëve jashtë dhe brenda vendit

Përfituesit/ Treguesit

- mbi 350 pjesëmarrës gjatë festivalit
- mbi 10 biznese pjesëmarrëse dhe bashkë organizues në festën
- mbi 5 këngëtarë dhe grupe artistike që performojnë gjatë festivalit
- të gjithë qytetarët e Korçës dhe rajonit janë pjesëmarrës gjatë festës
- Bizneset lokale (Hotel/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

Programi i Aktiviteteve:

1. Ngritja e grupit të punës
2. Përgatitja e materialeve promocionale (baner, fletëpalosje, forex)
3. Realizimi i infrastrukturës (pajisje teknike , marrje me qera etj)
4. Njoftimi i pjesëmarrësve
5. Kontakti dhe përgatitja e Shoë-it
6. Kontakti i mundshëm me biznese dhe donatorë
7. Promovimi i eventit
8. Realizimi i eventit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:



BASHKIA KORÇË

Festivali i vjeshtës synon për vitet e ardhshme një numër më të lartë pjesëmarrjeje dhe një aktivitet më të zgjeruar.

Rezultate:

- Frekuentues nga të gjitha moshat të aktiviteteve të organizuara nga Bashkia
- Rritja e turizmit dhe të ardhurave në biznes
- Promovimi i Korçës si një qytet i mbushur me aktivitete

Kostoja Totale: 200,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

Titulli i projektit: Korça Motor Show

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Për të gjithë të apasionuarit e motorave, Bashkia Korçë mundëson një ditë ndryshe nga rutina e përditshme e mbushur plot me emocione dhe spektakël duke prezantuar modele të ndryshme motorash si dhe një festival “Rock” në qendër të qytetit. Aktiviteti organizohet me pjesëmarrjen e 300 motoristëve nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia, të cilët kanë realizuar aktivitete në vende të ndryshme të Shqipërisë. Nisma për këtë organizim erdhi nga grupi i motoristëve korçarë, “Riders Legend”, ndërsa synimi është që ky të kthehet në një event të përvitshëm.

Qëllimi:

Zhvillimi i turizmit të aventurës në rajon si dhe promovimi i qytetit.

Objektiva:

- Një risi ndryshe nga rutina e përditshme
- Zhvillimi i turizmit të aventurës
- Zhvillimi i ekonomisë lokale
- Gjallërimi i jetës sociale dhe kulturore

Përfituesit/ Treguesit

- mbi 500 pjesëmarrës në festë
- mbi 10 biznese pjesëmarrëse dhe bashkë organizues në aktivitet
- Kalimtarë të rastit, të cilëve ju tërheq vëmendjen aktiviteti
- Vizitorët vendas dhe të huaj
- Bizneset lokale (Hotel/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Përgatitja e materialeve promociionale (baner)
- Realizimi i infrastrukturës (marrje me qera set tavolina, stola etj)
- Lajmërimi i pjesëmarrësve
- Kontakti dhe përgatitja e Show-t
- Promovimi i eventit në media dhe rrjete sociale
- Realizimi i eventit



BASHKIA KORÇË

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Korça Motor Show zhvillohet për të katërtin vit rradhazi duke shënuar rritje të numrit të vizitorëve dhe pjesëmarrësve në aktivitet.

Rezultate:

- Pjesëmarrje e lartë nga viti i kaluar
- Promovim si një qytet i pasuruar me aktivitete dhe spektakël
- Vizitorë vendas dhe të huaj më të shumtë në numër

Kostoja Totale: 192,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

Titulli i Projektit: Ditët e Luleve

Kohëzgjatja: Prill- Maj 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit: Bashkia e Korçës gjatë muajit Prill- Maj organizon çdo vit Panairin e Pranverës. Duke qenë se Korça dallohet për traditën e dekorimit të oborreve të shtëpive dhe pallateve me lule shumëngjyrëshe, Bashkia ka vendosur që këtë vit të çelë pranverën me një panair lulesh, të organizuar në Zonën Pedonale të qytetit. Përveç panairit të luleve nuk do të mungojnë edhe aktivitetet për fëmijë, ndërkohë që edhe dekori i veçantë që lidhet me pranverën e bën Korçën shumë të dashur dhe atraktive për të gjithë turistët që e vizitojnë.

Qëllimi: Promovimi i traditës së hershme të qytetit për kultivimin e luleve përmes shfaqjes së trashëgimisë tonë shpirtërore dhe vlerave tradicionale të zonës.

Objektiva:

1. Gjallërimi i jetës përmes zhvillimit të aktiviteteve të veçanta në qytet
2. Promovimi i bizneseve lokale të cilat promovojnë dhe tregëtojnë lule.
3. Ruajtja e traditës së përkujdesit për lulet dhe transmetimi i kësaj tradite tek brezat e rinj.

Programi i Aktiviteteve:

1. Përgatitja e procedurave për realizimin e zërave të projektit.
2. Konceptimi për realizimin e materialeve promocionale, konkretisht përgatitja e një baneri që do të vendoset në ambientet ku do të zhvillohet aktiviteti.
3. Kontakte me dyqanet që tregëtojnë lule për të marrë pjesë në panair dhe për të promovuar lloje të veçanta lulesh.
4. Organizimi me nxënësit e shkollave të sistemit parauniversitar, me të cilët do të organizohen aktivitete të ndryshme.
5. Realizimi i aktivitetit “Ditët e Luleve”
6. Përgatitja e dokumentacionit përmblyës për realizimin e projektit (relacion, foto nga aktiviteti).

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Projekti ka treguar interes dhe sukses të plotë vitin e parë të realizimit të tij për të gjithë banorët e Korçës, por edhe për vizitorët vendas dhe të huaj.

Rezultatet: Promovimi i shumëllojshmërisë së luleve që qyteti ynë kultivon dhe kthimi i aktivitetit në një traditë të përvitshme, e cila ka për qëllim të ndikojë drejtpërdrejt në nxitjen e turizmit kulturor, argëtimin e banorëve dhe ruajtjen e traditës së përkujdesit ndaj luleve.



BASHKIA KORÇË

Kostoja Totale: 66.400 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Titulli i projektit: Guidë promovuese e qytetit të Korçës

Kohëzgjatja: Gjatë vitit 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Realizimi dhe promovimi i paketave turistike luajnë një rol kyç në fushën e turizmit duke rritur numrin e turistëve vendas dhe të huaj. Bashkia Korçë do të organizojë një tour operator me agjensitë turistike të cilat sjellin turistë të huaj në Shqipëri për të përfshirë dhe promovuar qytetin dhe vlerat e tij kulturore, sociale, argëtuese dhe ekonomike.

Qëllimi:

Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i lidhjeve me agjensitë turistike që sjellin turistë të huaj në Korçë.

Objektiva:

- 1) Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave .
- 2) Promovimi i zonës dhe fshatrave turistike përreth saj
- 3) Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore
- 4) Forcimi i marrëdhënive me agjensitë turistike për rritje të numrit të vizitorëve
- 5) Promovimi i qytetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- 6) Vendorsje të urave të bashkëpunimit mes agjensive turistive dhe bizneseve lokale që operojnë në fushën e turizmit

Përfituesit/ Treguesit:

- Bizneset lokale të rajonit që operojnë në fushën e turizmit
- Të gjithë banorët vendas të rajonit

Programi i Aktiviteteve:

- Identifikimi i agjensive turistike që operojnë në Shqipëri, Greqi, Maqedoni
- Kontaktimi i agjensive turistike dhe njohja me paketat dhe ofertat turistike që ofrojnë
- Prodhimi i materialeve promociionale (hartë qyteti)
- Hartimi i ftesës dhe programit të vizitës
- Promovimi i atraksioneve dhe vlerave kulturore dhe trashëgimisë që ofron Korca
- Realizmi i një turi në qytet për të promovuar atraksionet turistike

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Ky projekt do të shërbejë për të promovuar Korçën si destinacion turistik përmes paketave të ndryshme që do të ofrojnë agjensitë turistike. Vendorsja e marrëdhënive të bashkëpunimit me këto agjensi do të ndikojë në rritjen e numrit të turistëve në qytet.

Rezultate:

- Promovimi i qytetit dhe atraksioneve të tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- Rritje të numri të turistëve
- Rritje të numrit të paketave të turistike për Korçën



BASHKIA KORÇË

- Rritje e kohëqëndrimit të vizitorëve

- Bashkëpunimit mes agjensive turistive dhe bizneseve lokale që operojnë në fushën e turizmit

Kostoja Totale: 305,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: Projekti do të realizohet në bashkëpunim me agjensitë turistike që operojnë në Shqipëri, Greqi dhe Maqedoni.

Titulli i projektit: 2B Bazaar Festival

Kohëzgjatja: Gjatë muajit Shtator 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia e Korçës në kuadrin e zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të qytetit si dhe për të nxitur dhe promovuar talentet e reja muzikore do të organizojë në muajin Shtator 2021, aktivitetin “2B Festival” ku do të marrin pjesë grupe të reja rock-u jo vetëm nga Shqipëria por edhe nga trevat shqiptare, si Maqedoni dhe Kosovë, të cilët do të performojnë live për një periudhë tre ditore në një prej destinacioneve më atraktive dhe turistike siç është “Pazari i Vjetër” i Korçës duke krijuar mundësi për të gjithë të apasionuarit e muzikës rock që të argëtohen nën tingujt e kësaj muzike. Festivali i rokut, krahas shumë festave dhe eventeve madhore që realizohen në Korçë, do të jetë një tjetër aktivitet madhor, i cili do të zhvillohet çdo vit duke shndërruar qytetin në promotorin e muzikës rock.

Qëllimi: Zhvillimi i turizmit në rajon si dhe promovimi i qytetit përmes aktiviteteve kulturore.

Objektiva:

- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj
- Rritja e të ardhuravë të bizneseve që lidhen direkt apo indirekt me turizmin (bare, restorante, etj).
- Gjallërimi i jetës në qytet përmes realizimit të aktivitetit
- Zhvillimi i turizmit në rajon, promovimi i qytetit si dhe forcimi i traditave të Korçës dhe rrethinave.
- Promovimi i grupeve me artistë të rinj të talentuar

Përfituesit/ Treguesit

- 2B Festival bën bashkë:
- mbi 10 grupe të reja të muzikës rock jo vetëm nga Shqipëria por dhe nga trevat e tjera shqiptare si Kosovë dhe Maqedoni
- Të gjithë të rinjtë e rajonit të apasionuar pas muzikës rock
- Vizitorë vendas dhe të huaj

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakti me pjesëmarrësit për bashkëpunim
- Realizimi i infrastrukturës në (marrje me qera skene pajisje, skenë, foni, ndriçim)
- Realizimi i dekorit festiv
- Realizimi i materialeve promocionale (baner, ftesa, citylight, etj)
- Njoftimi i qytetarëve
- Kontakti dhe me biznese dhe donatorë
- Promovim dhe marketing i aktivitetit



BASHKIA KORÇË

- Realizimi i eventit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

2B Festival synon që të kthehet në traditë dhe me një pjesëmarrje më të lartë çdo vit.

Rezultate:

- Gjallërimi i jetës kulturore, artistike në Rajonin e Korçës
- Rritja e numrit të vizitorëve
- Promovim i zonës
- Promovim i vlerave kulturore
- Rritje të numrit të rinjve që frekuentojnë aktivitetet e organizuara nga Bashkia Korçë

Kostoja Totale: 1.300.000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Shënime: 2B Festival do të zhvillohet në Qendër të Pazarit të Vjetër, Korçë.

Titulli i projektit: Dita Ndërkombëtare e Tokës

Kohëzgjatja: 22 Prill 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Data 22 prill, njihet në gjithë botën, si Dita Ndërkombëtare e Tokës. Kjo është një ditë që shërben për të dhënë alarmin për demet që njerëzimi i shkakton pyjeve, lumenjve, tokës dhe pasurive të tjera të natyrës dhe të reflektoj e sensibilizohet për të ndalur shkatërrimin e mëtejshëm të saj. Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë do të realizojë një ekspozitë fotografike të titulluar “Element” me objektet arkitekturore të rëndësishme të qytetit të Korçës, e cila do të çelet në datën 22 Prill 2021 dhe do të qëndrojë e hapur disa ditë për të gjithë qytetarët, nxënësit e shkollave, por edhe për të gjithë vizitorët vendas dhe të huaj.

Qëllimi:

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë është angazhuar të kryejë një ekspozitë , me qëllim rritjen e sensibilizimit qytetar ndaj objekteve me vlera të veçanta arkitekturore të qytetit.

Programi i aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Përzgjedhja dhe printimi i fotove në kanavacë për realizimin e ekspozitës
- Përgatitja e ftesave për pjesëmarrësit në aktivitet
- Përgatitja e infrastruktures së nevojshme për ekspozimin e fotografive
- Promovimi i aktivitetit ne media dhe rrjetet sociale
- Realizimi i ekspozitës fotografike

Rezultate:

- Identifikimi i objekteve arkitekturore të qytetit
- Ndërgjegjësim mbi ruajtjen dhe sigurinë e mjedisit ku jetojmë
- Angazhim i qytetarëve lidhur me dobinë e mjedisit
- Angazhim dhe sensibilizim i nxënësve të shkollave.

Kostoja totale: 160,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë



BASHKIA KORÇË

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

8.12.Fondi rezervë 04910

Njësia shpenzuese: Bashkia

Për vitin 2021 fondi i planifikuar është në vlerën 2,000 mijë lekë.

Fondi rezervë do të përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve të paparashikuara, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Buxheti vendor përfshin një fond rezervë, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara.

8.13.Fondi i kontigjencës 04940

Njësia shpenzuese Bashkia

Për vitin 2021 fondi i planifikuar është në vlerën 1,000 mijë lekë.

Buxheti vendor përfshin një fond kontigjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli bashkiak në buxhetin vjetor të bashkisë deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, përjashtuar transfertat e kushtëzuara. Fondi i kontigjencës është fondi i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme, për të ardhurat dhe shpenzimet, gjatë zbatimit të buxhetit. Gjithashtu fondi i kontigjencës krijohet për të përballuar edhe efektet e mosrealizimit të të ardhurave dhe efektet e paparashikuara të normave të interesit.

8.14.Programi: Menaxhimi i Mbetjeve 05100

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Buxheti i këtij program është në vlerën 113,378 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 630 mijë lekësh
- shpenzime korrente në vlerën 112,748 mijë lekë

000/lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Transferta tek organizatat	Totali
600	601	602	604	
540	90	83,118	29,630	113,378



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për paga për supervizorin e pastrimit është 540 mijë lekë në të njëjtin nivel me vitin 2020.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për supervizorin e pastrimit është 90 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shërbimin e pastrimit të qytetit sipas kontratës do të jetë në vlerën 79,618 mijë lekë, sipas kontratës së lidhur me Korsel, shpk e cila përfundon në qershor 2023.

Shërbimi i pastrimit është një nga më të rëndësishme që kryen Bashkia në komunitet. Ky shërbim kryhet nëpërmjet kontraktimit me palë të treta brenda qytetit dhe për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave të fshatrave. Objekti i këtij shërbimi është pastrimi i rrugëve dhe trotuareve, evadimi i mbetjeve urbane në qytetin e Korçës dhe transportimi i tyre për në landfillin rajonal, lagja e rrugëve ,evadimi i dëborës në stinën e dimrit dhe hedhja e kripës për lehtësimin e qarkullimit të automjeteve dhe njerëzve si dhe grumbullimi dhe evadimi i mbetjeve të fshatrave. Pastrimi i rrugëve bëhet cdo ditë prej orës 24 : 00 deri 06 : 00 . Pastrohen cdo ditë 419,369 m2 rrugë dhe trotuare dhe fshihen me fshesë mekanike 171,290 m2 në ditë . Transporti i mbeturinave për në landfill bëhet cdo ditë me mjete teknologjike prej orës 03 : 00 deri 07 : 00 për evadimin e mbetjeve nëpër konteniere dhe prej orës 07:00 deri 11 : 00 nëpër lagjet që nuk kane konteniere. Cdo ditë do evadohen rreth 55 ton mbeturina duke përfshirë qytetin dhe fshatrat. Nga projekti i qarkut Korçë për qendrat administrative janë shpërndarë 240 kosha plastike në shkollat dhe në vende të tjera për kryerjen e riciklimit. Janë vendosur 100 kazanë jeshile në qytet dhe 50 kazanë në fshatra me qëllim reduktimin e mbetjeve. Lagja e rrugëve bëhet për periudhen 01.04 deri në 31.10 cdo ditë nga ora 06:00 deri në 18:00 në një sipërfaqe 188.208 m2 si dhe larje speciale e rrugëve me sip. 67.508 m2 cdo ditë. Grumbullimi i mbeturinave bëhet me rreth 450 konteniere në qytet cdo ditë dhe 150 konteniere në fshat që do të evadohen tre herë në javë.

Në buxhetin e vitit 2021 do të planifikohet edhe vlera prej **3,500 mijë lekë** e cila do të perdoret për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve inerte të krijuar nga ndërtimet.

Fondi i planifikuar tek transfertat për organizatat është **29,630 mijë lekë**, e cila përfshin pagesën sipas faturave mujore për depozitimin e mbetjeve në landfill (si aksioner i Administrimit të Mbetjeve të Qarkut Korçë sha (KRWM).

8.15.Programi: Ndërgjegjësimi Mjedisor 05630

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar si dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Programi mbulon veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore.

Buxheti i planifikuar për këtë program është në vlerën 2,042 mijë lekë

-shpenzime personeli në vlerën 2,042 mijë lekësh

Fondi i planifikuar për paga për vitin 2021 është 1,750 mijë lekë për 3 punonjës dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 350 mijë lekësh.



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2021 është 292 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 43 mijë lekësh.

8.16. Programi: Planifikimi Urban Vendor 06140

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program përfshin zhvillimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e planeve të zhvillimit urbanistik. Lëshimin e lejeve për ndërtime të reja, zhvillimin e tokës dhe veprimtari të tjera që ndikojnë në urbanistikën e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Planifikim i përgjithshëm, duke përfshirë formulimin, përditësimin, bashkërendimin dhe monitorimin e Planeve të Përgjithshme Vendore/Planeve të Zhvillimit Strategjik si dhe hartimin e planeve të zonimit dhe të rregullave të ndërtimit.

Buxheti i këtij program është në vlerën 28,571 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 10,105 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,466 mijë lekë
- shpenzime për hartim projektsh dhe oponenca teknike në vlerën 10,000 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 4,000 mijë lekë

					000/lekë
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Hartim projektsh dhe oponenca teknike	Investime	Totali
600	601	602	230	231	
8,655	1,450	4,466	10,000	4,000	28,571

Fondi i planifikuar për paga për këtë program është 8,665 mijë lekë për 10 punonjës nga 9 punonjë të planifikuar në vitin 2020 dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 është ka një rritje prej 955 mijë lekësh.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është 1,450 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 4,466 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 284 mijë lekësh.

Fondi i planifikuar për hartim projektsh dhe oponenca teknike është në vlerën 10,000 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për investime është në vlerën 4,000 mijë lekë do të përdoret për shpronësime në varrezat publike në Njësitë Administrative.

8.17. Programi: Shërbime Publike Vendore 06260

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si



BASHKIA KORÇË

dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.

Buxheti i planifikuar për këtë program për vitin 2021 është në vlerën 5,037 mijë lekë dhe nr. i punonjësve është 1, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 537 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,500 mijë lekë

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	000/lekë Shp operative	Totali
600	601	602	
460	77	4,500	5,037

Fondi i planifikuar për paga për mbikqyrësin e shërbimit të Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 460 mijë lekë, në të njëjtin nivel me vitin 2020.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për mbikqyrësin e shërbimit të Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 77 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shërbimin e Mirmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve është 4,500 mijë lekë sipas kontratës deri korrik 2021, me qëllim shtrirjen e shërbimit dhe në varrezat e reja. Ky shërbim konsiston në zërat e mëposhtëm:

- 1.Pastrim parcelash, rrugë dhe sheshe të brendshme ndërmjet blloqeve të varrimit
- 2.Mirëmbajtje drurë dhe shkurre dekorative
- 3.Mbjellje drurë dekorative
- 4.Kositje, grumbullim dhe transport bari
- 5.Mirëmbajtje bordure betoni të brendshme
- 1.Lyerje me gëlqere të bordurave dhe pemëve në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- 2.Ruajtja e objektit në varrezat publike dhe të dëshmorëve
- 3.Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve
- 4.Mirëmbajtje e varrezave të dëshmorëve nga amortizimi
- 5.Konsumi i ujit të pijshëm për mirëmbajtje dhe nevojat e qytetarëve

8.18.Programi: Ndriçim Rrugësh 06440

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Ky program përfshin administrimin, instalimin, vënien në funksionim, mirëmbajtjen, përmirësimin e ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike, etj. si dhe zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit



BASHKIA KORÇË

rrugor. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike (SECO) kanë nisur një inisiativë të re të përbashkët në prill 2019 të titulluar: Projekti i Bashkive të Zgjuara Energjie (PBZE). Synimi kryesor i tij është që të përmirësojë menaxhimin bashkiak të energjisë, të zvogëlojë konsumin e energjisë, të promovojë burimet e energjisë së rinovueshme dhe të lehtësojë ndryshimet e klimës në Shqipëri, duke i angazhuar bashkitë në inisiativa që promovojnë përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin.

Gjatë 3 fazave të procesit të përzgjedhjes, nga 28 bashki që morën pjesë në PBZE, Bashkia Korçë është ndër 4 bashkitë pilot të përzgjedhura për zbatimin e fazës së parë të PBZE. Sipas vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtar dhe shqiptar, bashkia jonë së bashku me tre bashki të tjera, ofron kushtet më të mira për të zhvilluar bashkërisht një Përfaqje të Përshtatshme Shqiptare të Menaxhimit të Energjisë, duke ju përshtatur nevojave tona dhe mjedisit individual. Në vlerësimin e ekspertëve ndërkombëtar dhe shqiptar, Bashkia jonë tregoi angazhim për të përmirësuar menaxhimin e energjisë në të dyja nivelet politike dhe teknike në administratën bashkiake. Ne jemi të gatshëm të kontribuojmë për investimet e parashikuara ose financiarisht ose me punë në këtë proces. PBZE do të na mbështesë në me asistencë teknike të plotë dhe mbështetje për ngritjen e kapaciteteve si dhe me investime për të treguar rezultate të prekshme në menaxhimin e mirë të energjisë në kohë për publikun.

Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në kuadrin e efijencës së energjisë, me vlerë 83,000,000 lekë (në kjo përfshihen: Investimi, Lidhja e kontratave, mbikqyrje, kolaudim).

Kontributi i Bashkisë Korçë për projektin zvicerian të efijencës së energjisë është planifikuar në vlerën **6,425 mijë lekë**.

8.19. Programi: Sport dhe Argëtim 08130

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program përfshin organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese. Buxheti i këtij program është në vlerën 73,535 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 67,712 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 5,823 mijë lekë

000/lekë			
Shp operative	Transferta tek organizatat	Investime	Totali
602	604	231	
787	66,925	5,823	73,535



BASHKIA KORÇË

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për realizimin e projekteve në këtë program është në vlerën 787 mijë lekë dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 231 mijë lekësh.

Projektet e detajuara si më poshtë:

Titulli i projektit: Korça Open Air

Kohëzgjatja: Dhjetor 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë në bashkëpunim me grupin e Aeronautikës Shqiptare organizon çdo vit gjatë mujait Dhjetor aktivitetin 3 ditor “Korça Open Air”. Në malin e Moravës, organizohen fluturime të lira të aeronautistëve nga vende të ndryshme të botës. Për të gjithë të apasionuarit pas sporteve në natyrë, do të zhvillohen fluturime të lira me ndihmën e profesionistëve. Pas përfundimit të garave gjatë aktivitetit, realizohet Ceremonia Zyrtare e ndarjes së çmimeve për fituesit e “Korça Open Air 2021”.

Qëllimi: Promovimi i aktiviteteve sportive të veçanta, për të gjithë të apasionuarit pas sporteve të aventurës në qytetin e Korçës.

Objektiva:

- Promovimi i Korçës nga një tjetër këndvështrim nga sporti i aventurës
- Pjesëmarrja e shteteve të huaja në kampionat
- 3 ditë të mbushura me spektakël dhe adrenalinë të cilat i japin veçanti qytetit
- Pjesë e kalendarit kulturor dhe artistik ku bëhen bashkë me atë sportiv në periudhën me të bukur të festave të fundvitit.
- Synimi është kthimi i këtij aktiviteti në një traditë kulturore
- Promovimi i qytetit në shtete të ndryshme
- Rritja e numrit të vizitorëve vendas dhe të huaj të apasionuar pas turizimit të aventurës në vitet në vazhdim

Përfituesit/ Treguesit

- Mbi 300 pjesëmarrës në festë gjatë 3 ditëve të organizimit të saj
- Vizitorët vendas dhe të huaj të apasionuar pas sporteve të aventurës
- Bizneset lokale (Hotele/bujtina/ bare/ restorante) që përfitojnë direkt në rritjen e ekonomisë

Programi i Aktiviteteve:

- Hartimi i kalendarit të eventeve të fundvitit
- Ngritja e grupit të punës
- Kontakte të përhershme me grupin e Aeronautikës
- Ndjekja e procedurave për akomodimin e grupit të aeronautikës
- Njoftim i qytetarëve që duan të bëhen pjesë e aktivitetit
- Promovim në media dhe në rrjetet sociale
- Realizimi tre ditor i aktivitetit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit:

Korça Open Air organizohet për të disatin vit radhazi duke shënuar rritje të numrit të pjesëmarrësve në aktivitet si dhe rritje të numrit të vizitorëve që frekuentojnë aktivitetin.

Rezultate:

- Realizimi i fluturimeve të lira nga ajri për të gjithë qytetarët, vizitorët vendas dhe të huaj.
- Nxitja e brezit të rinj për të frekuentuar aktivitetet që zhvillohen në natyrë.



BASHKIA KORÇË

- Promovimi i qytetit dhe turizmit të aventurës nëpërmjet aktiviteteve të veçanta.

Kostoja Totale: 675,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

Titulli i projektit: Idea Bombing

Kohëzgjatja: Prill- Qershor 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Duke vlerësuar mjaft pozitive eksperiencën e Bashkisë Korçë me krijimin e një bërthame brenda këtij institucioni i cili ka si qëllim zgjidhjen e problematikave në menyrë inovative me qëllim përmirësimin e jetës së qytetarëve, do të krijojë një konkurs për të përzgjedhur dhe fituar të gjitha idetë inovative që vijnë nga të rinjtë. Gjatë këtij konkursi të rinjtë që do të bëhen pjesë do të kenë mundësi të japin zgjidhje, ide apo të ngrenë dhe problematika që realisht kërkojnë zgjidhje jo vetëm për qytetin e Korçës por duke e shtrirë rrezën e veprimit edhe në njësitë administrative. Në fund të konkursit tre praktikantë më të mira do të futen në planet e implementimit të bashkisë Korçë.

Qëllimi:

- Të rritet përfshirja e të rinjve të vendimmare dhe zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të qytetit
- Të krijohet mundësi promovimi dhe shpalosjesh talentesh të reja të rinisë korçare
- Të ndjehen të përfshirë dhe të motivuar për një të ardhme të mirë të vendit

Rezultatet:

- Realizimi i konkursit dhe tre praktikantë më të mira.
- Thithja e ideve inovative nga të rinjtë
- Krijimi i një database më të rinj të talentuar dhe aktive në jetën e qytetit.

Kostoja totale: 112,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës.

Fondi i planifikuar për transferta tek organizatat është në vlerën 66,925 mijë lekësh dhe konkretisht:

Kontributi I Bashkisë Korçë për Qendren Sportive Korçë në vlerën 38,325 mijë lekësh dhe

Kontributi i Bashkisë Korçë për ekipet e futbollit në vlerën 28,600 mijë lekësh.

Informacioni i detajuar jepet përgjatë materialit.

Fondi i planifikuar për investime në vlerën 5,823 mijë lekë për objektin "Rikonstruksioni i pallatit të sportit "Tamara Nikolla".

8.20. Programi: Arsimi Bazë dhe Parashkollor 09120

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore



BASHKIA KORÇË

Mbështetja e arsimit bazë dhe parashkollor. Administrim dhe rregullim i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Buxheti i këtij program është në vlerën 20,700 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 700 mijë lekë
- Shpenzime kapitale në vlerën 20,000 mijë lekë

000/lekë

Shp operative	Investime	Totali
602	231	
700	20,000	20,700

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është 700 mijë lekë (shpenzime operative për shkollën e Maltës), dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 është në të njëjtin nivel.

Fondi i planifikuar për investime është 20,000 mijë lekë. Ky fond do të jetë bashkëfinancim i Bashkisë Korçë për investimet në arsim.

8.21. Programi: Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm 09230

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program ka në fokus zhvillimin e projekteve për të rinjtë.

Buxheti i këtij program është në vlerën 130 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 130 mijë lekë

Këto shpenzime në vlerën 130 mijë lekë do të përdoren për realizimin e projektit 9 maj dita e Europës.

Titulli i Projektit: 9 Maj, Dita e Europës

Kohëzgjatja: 9 Maj 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Në kuadrin e ditës së Evropës e cila celebrimet në çdo datë 9 maj me nxënës të shkollave publike do të organizohet një aktivitet sensibilizues me material artistike të përzgjedhura nga vetë nxënësit për të treguar mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian. Ky aktivitet do të zhvillohet me pjesëmarrjen e rreth 500 pjesëmarrësve dhe do të vazhdojë rreth një orë. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të njihen më mënyrën e krijimit, arsyet, zhvillimin dhe ecurinë e Bashkimit Evropian nëpërmjet krijimeve dhe materialeve të sjella nga vetë nxënësit.

Qëllimi: Organizimi i një aktiviteti sensibilizues për të ndërgjegjësuar brezin e ri me aktivitet me fokus Bashkimin Evropian.



BASHKIA KORÇË

Objektiva:

- Evidentimi i talenteve të rinjve në fusha të ndryshme artistike
- Pjesëmarrje aktive në aktivitete që lidhen me Bashkimin Evropian
- Ndërgjegjësim i tyre si qytetarë të ardhshëm të Bashkimit Evropian

Programi i Aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Përgatitja për realizimin e materialeve promocionale dhe dekorimin e ambjentit ku do të zhvillohet aktiviteti
- Përzgjedhja e materialeve që do të performohen gjatë aktivitetit
- Nisja dhe ndjekja e procedurave për përzgjedhjen e kuratorit, që do të merret me organizimin dhe rregullimin e aktivitetit, me organizimin e femijeve, programin, monitorimin dhe ndjekjen e periudhes së proves nga fëmijët deri në realizimin final të aktivitetit.
- Zhvillimi i aktivitetit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Ky aktivitet përkon me një ditë ndërkombëtare e cila festohet në të gjitha vendet Evropiane dhe si e tillë ky projekt do të ketë një qëndrueshmëri të gjatë. Nga viti në vit duke u bazuar tek eksperiencat do të përmirësohet duke iu përshtatur dhe tematikave të caktuara. Bashkia e Korçës e ka të planifikuar këtë aktivitet duke marrë shkas dhe nga ngritja dhe funksionimi i Njesisë së Integritit pranë kësaj bashkie.

Rezultate:

- Krijimi i aktivitetit me sukses
- Përfshirja e 30 nxënësve në organizimin e këtij aktiviteti.
- Përcjella e mesazhit tek rreth 400 nxënës të tjerë dhe shkëmbim praktike me shkolla të tjera të qytetit
- Angazhimi i nxënësve në gjetjen e materialeve dhe zgjerimi i njohurive të tyre në këtë drejtim.

Kostoja Totale: 130,000 Lekë

Institucioni Zbatues: Bashkia Korçë

Struktura Përgjegjëse: Njësia e Integritit Evropian

8.22. Programi: Sigurimi Shoqëror 10220

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Ky program përfshin administrimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rezidenciale për të moshuarit.

Buxheti i këtij program është në vlerën 4,434 mijë lekë e detajuar si më poshtë:

- shpenzime korrente në vlerën 4,434 mijë lekë

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 4,434 mijë lekë, ku përfshihet shpenzimet për qendrën e Kujdesit Paliativ “Mary Potter” në vlerën 1,850 mijë lekë dhe 2,584 mijë lekë janë shpenzime për realizimin e projekteve si më poshtë:

Detajimi i projekteve:

Titulli i Projektit: “Karta për pensionistët”



BASHKIA KORÇË

Kohëzgjatja: Janar 2021

Pershkrim i pergjithshem i projektit:

Të moshuarit pajisen me karta pensionisti, të cilat janë të personalizuar. Me to ata marrin disa shërbime falas dhe me cmim të reduktuar..

Qellimi: Ky projekt ka për qëllim krijimin e një sistemi shërbimesh falas apo me cmime të reduktuara në fusha me interes për të gjithë pensionistet e qytetit të Korcës.

Rezultatet: 800 pensionistë do të përfitojnë lehtësira në shërbimin e transportit si dhe në aspektin financiar

Objektivat:

Çdo pensionist përfiton:

- falas shërbimin e transportit urban,
- ndjekjen e ndeshjeve në stadium dhe në pallatin e sportit,
- ulje të cmimit të biletës në teatër në masën 50%,
- ulje në masën 20%- 50% në disa shërbime si në njësi tregtimi apo shërbimesh të nevojshme për moshën e tretë.
- disa shërbime e analiza mjekësore falas nga klinika në qytetin tonë.

Vlerat e projektit: Projekti synon të rritë mirëqënien e të moshuarve, duke i lehtësuar nga disa shpenzime shërbimesh të përditshme, me synim rritjen e cilësisë së jetesës së tyre.

Kosto buxheti Bashkia: 100.000 lekë

Nr total i pensionistëve të pajisur me "Karta Pensionisti"	Mazhorancë	Komuniteti Rom/Egjiptian	Gjinia Mashkullore	Gjinia Femërore
800	550	250	400	400
	275 Gj.M	125 Gj.M		
	275 Gj.F	125 Gj.F		

Për vitin 2021 është planifikuar të pajisen me "Karta Pensionisti" 800 të moshuar pensionistë. 31,25 % e buxhetit i përket komunitetit Rom/Egjiptian pjesa tjetër e buxhetit i përket mazhorancës.

Titulli i Projektit : "Qendra Komunitare për moshën e tretë" 2021

Kohëzgjatja: 12 muaj

Pershkrim i pergjithshem i projektit:

Qellimi: Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

Objektivat: Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit me qëllim zbutjen e problemeve të moshës së tretë dhe shmangies e izolimit social të tyre.

Objektiva 1: Ofrimi i një mjedisi çlodhës dhe mikëpritës për të moshuarit.

Objektiva 2: Ofrimi i shërbimeve të specializuara sociale nëpërmjet 3 kujdestarëve të qendrave, punonjësit



BASHKIA KORÇË

sociale dhe atij animator.

Objektiva 3: Organizimi i aktiviteteve social-kulturore, argëtuese

Objektiva 4: Përmirësimi i kushteve shëndetsore të frekuentuesve të Qendrave

Objektiva 5: Ofrimi i shërbimeve të tjera të nevojshme për të moshuarit.

Rezultatet: Krijimi i një ambjenti sa më mikëpritës në Qendrat Komunitare. Zvogëlimi i fenomenit të braktisjes dhe vetmisë të Moshës së Tretë. Vazhdimësia e përmirësimit të shërbimeve sociale në qytetin e Korcës.

Vlera e projektit: Qendrat ditore për moshën e tretë përmirësojnë jetën sociale të këtij target grupi, duke rritur kështu edhe cilësinë e jetës së tyre të përditshme.

Kosto buxheti Bashkia: 2,484,000 lekë

Nr i të moshuarve përfitues në qendra ditore "Moshë e tretë"	Mazhorancë	Komuniteti Rom/Egjiptian	Gjinia Mashkullore	Gjinia Femërore
200	130 115 Gj.M 15 Gj.F	70 60Gj.M 10 Gj.F	175 të moshuar	25 të moshuara

Për vitin 2021 është planifikuar të marrin shërbim rreth 200 të moshuar. Mbizotëron gjinia mashkullore sepse qendrat e të moshuarve frekuentohen më shumë nga të moshuar meshkuj.

35 % e buxhetit i përket komunitetit Rom/Egjiptian.

8.23. Programi: Kujdesi Social për Personat e Sëmurë dhe me Aftësi të Kufizuara 10140

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program përfshin krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Buxheti i këtij program është në vlerën 12,196 mijë lekë i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 11,940 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 256 mijë lekë

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 10,230 mijë lekë për 17 punonjës dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 është në të njëjtin nivel.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 1,710 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 256 mijë lekë, nga të cilat 106 mijë lekë për realizimin e projektit si më poshtë.

000/lekë



BASHKIA KORÇË

Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Totali
600	601	602	
10,230	1,710	256	12,196

Titulli i projektit: 3 Dhjetori “Dita Ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuar”

Kohëzgjatja:Dhjetor 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit: Me rastin e 3 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, Bashkia Korçë ka organizuar çdo vit aktivitete të ndryshme kulturore e sportive, në mënyrë që të rritë ndërgjegjësimin e shoqërisë për të lehtësuar gjithëpërfshirjen e tyre në jetën shoqërore.

Qëllimi: Rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve për t’ju ardhur në ndihmë kësaj shtresës në nevojë. Objektiva: Gjithëpërfshirja e PAK në aktivitetet kulturore dhe në jetën e përditshme.

Përfituesit/ Treguesit - 150 persona me aftësi të kufizuar, të cilët bëhen pjesë në aktivitet

Programi i Aktiviteteve:

1. Komunikimi me institucionet që punojnë me personat me aftësi të kufizuar.
2. Përzgjedhja e vendit për organizimin e marshimit për pjesëmarrësit.
3. Realizimi i materialeve promociionale (ftesa për donatorët, fletëpalosje për lajmërim të qytetarëve)
4. Realizimi i aktivitetit në datën 3 Dhjetor.
5. Përgatitja e dokumentacionit përmbyllës (relacion, foto).

Rezultatet: - Sensibilizimi i popullsisë për të mirëpritur PAK në jetën e përditshme. - Duke dëgjuar zërin e PAK do të mund të gjejnë zgjidhje sa më shumë pengesat që dalin përpara në rrugën e gjithëpërfshirjes.

Kosto buxheti Bashkia:106.000 lekë

Nr total i PAK pjesëmarrës në aktivitet	Mazhorancë	Komunitet Rom/Egjiptian	Gjinia Mashkullore	Gjinia Femërore
160	100 50 Gj.F 50 Gj.M	60 30 Gj.F 30 Gj.M	80 PAK	80 PAK

Për vitin 2021 është parashikuar të marrin pjesë në aktivitet 150 PAK. 37.5% e buxhetit i përket komunitetit Rom/Egjiptian.

8.24.Programi: Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët 10430

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

Ky program përfshin përfitimet në para apo pagesa të tjera periodike apo të njëhershme për të mbështetur familjet ose për t’i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike



BASHKIA KORÇË

dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare.

Buxheti i këtij programi është në vlerën 9,118 mijë lekë, i detajuar si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 4,366 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 4,752 mijë lekë

000/lekë				
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Transferta tek individët	Totali
600	601	602	606	
3,740	626	3,752	1,000	9,118

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 3,740 mijë lekë për 8 punonjës dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,835 mijë lekësh për shkak të rritjes së numrit të punonjësve, si rezultat i zbatimit të projektit me UNDP “Askush mos mbetet prapa”, “Ofrim shërbimesh multifunkionale tek Qendra e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (AK)”. Ky projekt ka filluar në vitin 2020 dhe fondet për shpenzime personeli janë financuar nga UNDP deri në shkurt të 2021.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 626 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 307 mijë lekësh .

Fondi i planifikuar për shpenzime operative është në vlerën 3,752 mijë lekë, krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një rritje prej 1,353 mijë lekësh, nga të cilat 2,674 mijë lekë do të përdoren për realizimin e projekteve në këtë program si më poshtë:

Detajimi i projekteve:

Titulli i Projektit : “Strehëzë emergjente” 2021

Kohëzgjatja: 12 muaj

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Marrja me qera e një apartamenti, pagesa e ujit dhe energjisë elektrike. Ky apartament shërben si strehëz për rastet emergjente të dhunës në familje. Në bashkëpunim me partnerët bëhet plotësimi i nevojave të tyre në veshmbathje dhe ushqim dhe shërbim psiko-social.

Qëllimi: Krijimi i një ambjenti familjar dhe të sigurt për viktimat e dhunës në familje në momentin emergjent që paraqitet.

Objektivat:

1. Marrja me qera e një apartamenti që do të shërbejë si strehëz emergjente.
2. Akomodimi i personave të dhunuar deri në kalim e emergjencës që paraqet rasti.



BASHKIA KORÇË

3. Sigurimi i shërbimeve të tjera të nevojshme që do të mundësohen nga një organizatë jo qeveritare.

Rezultatet: Viktimat e dhunës në familje do të kenë një strehim të sigurt larg ambjentit të dhunshëm deri në momentin e akordimit të Urdhërit të Menjëhershëm të Mbrojtjes ose Urdhërit të Mbrojtjes nga Gjykata Rrethit Gjyqësor Korçë.

Gjatë qëndrimit në strehëz të mbijetuarat e dhunës dhe fëmijët e tyre do të marrin shërbim psiko- social dhe mbulimin e nevojave të tyre në veshmbathje, shtresa për fjetje, ushqim, ngrohje ambjenti, ujë të ngrohtë, produkte higjieno- sanitare, enë kuzhine, shtretër të vegjël për fëmijë, ushqim i veçantë për grup-moshën 0-3 vjeç. Përfituesit kanë mundësi edhe për zbavitje, si p.sh lodra për fëmijë, televizor, radio etj.

Përfituesit duhet të kujdesen vetë për pastrimin e ambjentit dhe gatimin nëse qëndrimi i tyre është për një afat më të gjatë se dy ditë, në rastin e Urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes dhe 20 ditë deri në akoordinimin e Urdhërit të mbrojtjes.

Vlera e projektit: Ky projekt ka shumë rëndësi në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje . Strehimi i tyre është një shërbim bazë në uljen e rrezikut për viktimën e dhunës në familje, që mund të rrezikojnë edhe humbjen e jetës.

Kosto buxheti Bashkia: 288 000 lekë

Titulli i Projektit: Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje.

Kohëzgjatja: Janar 2021 në vazhdimësi

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Në Njësitë Administrative nuk ka struktura të mirëngritura për menaxhimin e rasteve në territorin e tyre. Kjo bën që personat që janë viktimat të dhunës në familje, kryesisht gra dhe fëmijë, ta kenë të vështirë që të vetëm të dalin nga situata në të cilën ndodhen. Pranë këtyre njësive është e domosdoshme prania e një grupi multidisiplinar, i cili do të asistojë këta persona.

Ky projekt është projektuar për të përmirësuar shërbimet dhe për të forcuar mekanizmin e referimit të rasteve të dhunës në familje, jo vetëm në nivel të bashkisë, por edhe në nivel Njësie Administrative. Shumica e Njësive Administrative nuk ka ekip teknik të ngritur, por vetëm një person përgjegjës, i cili nuk e ka detyrë funksionale menaxhimin e rasteve të dhunës.

Popullata e Njësive Administrative duhet informuar, sepse ka mungesë informacioni. Menaxhimin e rastit pas referimit e bën Bashkia qendër.

Megjithëse numri i denoncimeve është në rritje, përsëri, duhet kryer një sensibilizimin i popullsisë në zonat rurale, me komunitetin parashkollor dhe atë të shkollave me qëllim që të kontribuojmë në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.

Qëllimi: Sensibilizimi i komunitetit mbi fenomenin e dhunës në familje

Objektivat:

-Komuniteti i zonave rurale do të marrë informacion mbi fenomenin e dhunës në familje dhe pasojat negative që ai sjell.

-Do të marrë informacion të nevojshëm për mënyrën sesi mund të denoncohet dhuna.



BASHKIA KORÇË

- Do të informohet rreth shërbimeve që ofrohen dhe rëndësinë që ka denoncimi.

Rezultatet: Rritja e sensibilizimit të popullsisë në zonat rurale.

Vlera e projektit: Një aspekt shumë i rëndësishëm në luftimin e dhunës në familje është bërja e njohur e fenomenit dhe aspekteve negative të tij. Nga statistikat rezulton që komuniteti i zonave rurale, kryesisht gra dhe vajza, ndonëse të dhunuara, nuk raportojnë për dhunën e ushtruar. Sensibilizimi është mjaft i rëndësishëm në mënyrë që të rritet denoncimi ndaj krimit të dhunës në familje në këto zona.

Kosto buxheti Bashkia: 136.900 lekë

Personat pjesëmarrës total në Ndërgjegjësimi i komunitetit nëpërmjet aktiviteteve sensibilizuese në luftën kundër dhunës në familje"	Nxënësit e shkollave 9 vjecare-shkollat e mesme	Komuniteti Rom/Egjiptian	Mazhorancë	Gjinia Femërore	Gjinia Mashkullore
300	130	85	85	150	150
	1. 32 Gj.M (Mazhorancë)	43 Gj.F 42 Gj.M	43 Gj.F 42 Gj.M		
	2. 33 Gj.F (Mazhorancë)				
	3. 32 Gj.M (K.Rom/Egjiptian)				
	4. 33 Gj.F (K.Rom/Egjiptian)				

Titulli i projektit: Dita Ndërkombëtare e gruas

Data : 8 mars 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

8 marsi njihet si "Dita e Gruas", në të gjithë botën. Madje në shtete të ndryshme kjo ditë festohet si festë kombëtare. Kjo ditë shërben jo vetëm për bashkimin e grave pa dallim feje, race, kulture, gjuhe dhe prejardhjeje, por edhe për të kujtuar përpjekjet për barazi, paqe, drejtësi dhe ndërtim në gati 9 dekada.

Qëllimi:

Në kuadër të kësaj dite, Bashkia Korçë është angazhuar të kryejë një sërë aktiviteteve jo vetëm në qytet por edhe në njësitet administrative, me qëllim sensibilizim qytetar.

Rezultate:

- Sensibilizim qytetar
- Mirënjohje ndaj përpjekjeve për barazi dhe drejtësi
- Bashkim të grave pa dallime

Kostoja totale: 213,000 Lekë

Titulli i Projektit : Qendra ditore për fëmijë – Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë 2021



BASHKIA KORÇË

Kohëzgjatja: 12 muaj

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Qendrat ditore të fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve të përditshme synojnë të risin mirëqënien e fëmijëve të grupeve të marxhinalizuara duke i aftësuar gjithashtu për jetën dhe jetën në komunitet.

Ky projekt është planifikuar të zhvillohet edhe për vitin 2021 për të shmangur efektet e izolimit social dhe problematikat e ndryshme me të cilat përballet komuniteti rom dhe egjiptian. Janë planifikuar shërbim në qendrën ditore të fëmijëve 100 fëmijë.

Fëmijët i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian. I gjithë buxheti është dedikuar për fëmijë që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.

Fëmijë të rregjistruar në qendrën ditore të fëmijëve	Gjinia Mashkullore	Gjinia femërore	Komuniteti Rom/Egjiptian
100	50 fëmijë	50 fëmijë	100 fëmijë

Qëllimi: Fuqizimi i fëmijëve Romë dhe Egjiptianë

Objektivat: Të përmirësojë mirëqënien e komunitetit Rom dhe atij Egjiptian përmes integritit social dhe reduktimit të varfërisë

Rezultatet:

1. Fëmijët Romë / Egjiptiane regjistrohen në shkollën fillore dhe janë të monitoruar pas shkollës në tre qendrat ditore të fëmijëve.
2. Fëmijët Romë/Egjiptiane fitojnë me shume besim në vetevete nëpërmjet asistencës psikologjike, aktivitete sociale dhe iniciativa të tjera mbi barazine gjinore.
3. Fëmijët romë /Egjiptiane kanë qasje në kujdesin shëndetësor dhe janë bërë të vetëdijshëm për çështjet në lidhje me shëndetin.
4. Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes i prindërve Romë&Egjiptiane është rritur nëpërmjet themelimit të Komitetit të Prindërve.
5. Kapacitetet arsimore të fëmijëve janë rritur nëpërmjet kurseve të anglishtes, kompjuterit dhe kurseve të qepjes si dhe kurseve të gjuhës shqipe dhënë nënave të tyre.
6. Shëndeti i 40 fëmijëve të kequshqyer është përmirësuar si rezultat i ushqimit të shëndetshëm dhe trajnimeve mujore të prindërve mbi këtë temë nga pediatri.
7. Si rezultat i lobimit mbështetja ndaj këtij grupi përfituesish është rritur.

Vlera e projektit: Qendrat ditore për fëmijët janë një aspekt i rëndësishëm i shërbimeve sociale të bashkisë, që rrisin mirëqënien e këtij target grupi.

Kosto buxheti Bashkia : 1,776,000 lekë

Titulli i Projektit: 24 Qershor ; Dita ndërkombëtare e egjiptianëve.

Kohëzgjatja: Maj-Qershor 2021



BASHKIA KORÇË

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Zhvillimi i një aktiviteti sensibilizues me anëtarë të komuniteti egjiptian, ku do të përcillen vlerat e tyre kulturore dhe etnike. Anëtarë të komunitetit egjiptian dhe organizatat me bazëkomunitare do të jenë pjesë e këtij aktiviteti.

Qëllimi: Promovimi i Vlerave dhe Kultures Egjiptian.

Objektivat: Promovimi i Kulturës dhe Traditës Egjiptian.

Rezultatet: Me rastin e 24-të Qershorit do të zhvillohet një aktivitet sensibilizues ku do të pasqyrohen vlerat kulturore dhe etnike të komunitetit egjiptian. Për të pranishmit do të ketë edhe një koktejl.

Në një ambient publik të qytetit me ndihmën e shoqatave egjiptiane dhe donatorëve që kanë në zbatim projekte për komunitetin do të zhvillohet një panair me punime nga anëtarë të komunitetit egjiptian, të cilët do të tregojnë vlerat e trashëguara brez pas brezi siç janë punimet artizanale.

Vlerat e projektit: Me anën e këtij projekti do të promovohen vlerat e komunitetit egjiptian, një komunitet që konsiderohet i diskriminuar, por që mbart në vetvete kulturë dhe vlera të veçanta, të cilat nuk njihen nga opinioni i gjërë. Synohet që nëpërmjet aktivitetit të dalin në pah aspektet pozitive të këtij komuniteti.

Kosto buxheti Bashkia: 30,000 lekë

Për vitin 2021 është parashikuar të zhvillohet aktiviteti në datën 24 Qershor “Dita Ndërkombëtare e Egjiptianëve” me 300 persona. I gjithë buxheti i është dedikuar komunitetit egjiptian.

Nr total i personave pjesëmarrës (Komuniteti Egjiptian) në aktivitet	Gjinia Femërore (Komuniteti Egjiptian)	Gjinia Mashkullore (Komuniteti Egjiptian)
300 persona	150 persona	150 persona

Titulli i Projektit: 8 prilli; Dita ndërkombëtare e romeve

Kohëzgjatja: Mars-Prill 2021

Përshkrim i përgjithshëm i projektit:

Zhvillimi i një aktiviteti sensibilizues me anëtarë të komuniteti rom, ku do të përcillen vlerat e tyre kulturore dhe etnike. Anëtarë të komunitetit Rom dhe organizatat me bazëkomunitare do të jenë pjesë e këtij aktiviteti.

Qëllimi: Promovimi i Vlerave dhe Kultures Rome.

Objektivat: Promovimi i Kulturës dhe Traditës Rome.

Rezultatet: Në 8-Prill 1971 u organizua takimi i parë ndërkombëtar i Romëve në Londër, që prej asaj dite, 8 Prilli është cilësuar dhe vazhdon të kujtohet si Dita Ndërkombëtare e Romëve.

Me rastin e 8-të Prillit do të zhvillohet një aktivitet sensibilizues ku do të pasqyrohen vlerat kulturore dhe etnike të komunitetit rom. Për të pranishmit do të ketë edhe një koktejl.

Në një ambient publik të qytetit me ndihmën e shoqatave rrome dhe donatorëve që kanë në zbatim projekte për komunitetin do të zhvillohet një panair me punime nga anëtarë të komunitetit Rom, të cilët do të tregojnë vlerat e trashëguara brez pas brezi siç janë punimet artizanale.

Vlerat e projektit: Me anën e këtij projekti do të promovohen vlerat e komunitetit rom, një komunitet që konsiderohet i diskriminuar, por që mbart në vetvete kulturë dhe vlera të veçanta, të cilat nuk njihen nga



BASHKIA KORÇË

opinionit i gjërë. Synohet që nëpërmjet aktivitetit të dalin në pah aspektet pozitive të këtij komuniteti.

Kosto buxheti Bashkia: 30,000 lekë

Për vitin 2021 është parashikuar të zhvillohet aktiviteti në datën 8 Prill “Dita Ndërkombëtare e Romëve me 300 persona. I gjithë buxheti i është dedikuar komunitetit Rom.

Nr total i personave pjesëmarrës (Komuniteti Rom) në aktivitet	Gjinia Femërore (Komuniteti Rom)	Gjinia Mashkullore (Komuniteti Rom)
300 persona	150 persona	150 persona

Titulli i Projektit: Aktivitet promovues në Kopshtet Komunitare

Kohëzgjatja: Shtator 2021

Përshkrim i shkurtër i projektit:

Bashkia Korçë do të organizojë gjatë muajit Shtator 2021, në ambientet e Parkut Japonez dhe Kopshteve Komunitare një Panair simbolik me produkte lokale, i cili ka për qëllim përmirësimin e raporteve të komunitetit, prodhimin e ushqimeve të shëndetshme dhe promovimin e iniciativave për t’u marrë me kopshtari.

Në panair do të marrin pjesë familjet e angazhuara në Kopshtet Komunitare, të cilat janë kujdesur për produktet (fruta, perime, lule, etj.), duke kaluar kohë cilësore së bashku dhe duke zhvilluar frymën komunitare. Frutat dhe perimet që kultivohen nga familjet në këto kopshte, dhurohen në ndihmë të fëmijëve dhe personave të moshuar në nevojë, në institucionet e kujdesit social në Korçë. Për realizimin e aktivitetit do të përzgjidhet një kurator, i cili do të kujdeset dhe do të koordinojë të gjitha aspektet logjistike për realizimin e aktivitetit në bashkëpunim me organizatorët dhe mbështetësit e aktivitetit.

Qëllimi: Promovimi i iniciativave për t’u marrë me kopshtari, me qëllim përfshirjen e sa më shumë njerëzve në aktivitete të bujqësisë urbane, e cila është jo vetëm argëtuese, por edhe tepër e dobishme për të edukuar tek brezat e rinj ushqyerjen e shëndetshme.

Objektiva:

- Nxitja e iniciativave të bashkëpunimit social në komunitet.
- Ritja e angazhimit vullnetar të familjeve dhe edukimi i vullnetarizmit tek brezat e rinj

Programi i aktiviteteve:

- Ngritja e grupit të punës
- Kontakte me donatorë të ndryshëm dhe biznese për të mbështetur aktivitetin
- Nisja dhe ndjekja e procedurave për përzgjedhjen e kuratorit të aktivitetit
- Përgatitja e infrastruktures së nevojshme për aktivitetin (stenda, stola, tavolina për ekspozimin e produkteve, sigurimi i ndriçimit, etj)
- Promovimi i aktivitetit në rrjetet sociale
- Realizimi i aktivitetit

Risia dhe Qëndrueshmëria e projektit: Panairi me prodhime lokale, i realizuar për herë të parë gjatë vitit 2020, u vizitua jo vetëm nga vizitorët vendas dhe të huaj, por u vlerësua edhe nga familjet e angazhuara, si një eksperiencë shpërblyese e punës së tyre nëpër parcela, të cilët kanë pritur me padurim, që të vjelin



BASHKIA KORÇË

shumë shpejt prodhimet e tyre. Për këtë arsye aktiviteti synon të kthehet në një event të përvitshëm, që tërheq vëmendjen e gjithë grupmoshave.

Rezultatet:

- Krijimi dhe shtimi i hapësirave të gjelbra në qytet nga 15 familjet e para të angazhuara vullnetarisht
- Kultivimi i prodhimeve bujqësore nga më të ndryshmet, sipas dëshirës së familjeve që kujdesen për produktet në parcela
- Rritja e numrit të familjeve që angazhohen vullnetarisht dhe përkujdesen për parcelat në Kopshtet Komunitare.
- Tërheqja e vizitorëve vendas dhe të huaj ndaj kësaj nisme tepër të suksesshme dhe të veçantë.

Kostoja totale: 200.000 Lekë

Institucioni zbatues: Bashkia Korçë

Struktura përgjegjëse: Drejtoria e Turizmit, Teknologjive të Informacionit, Arsimit, Migracionit dhe Diasporës

Në këtë buxhet është përfshirë dhe vlera prej **1,000 mijë lekë transfertë tek individët** dhe konkretisht ndihmë ekonomike për familjet në nevojë (3% i fondit të ndihmës ekonomike).

8.25.Programi: Strehimi Social 10661

Burimi i financimit: Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore

Ky program merret me përfitimet në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit.

Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë.

Buxheti i këtij program është në vlerën 5,630 mijë lekë është si më poshtë:

- shpenzime personeli në vlerën 730 mijë lekë
- shpenzime korrente në vlerën 900 mijë lekë
- shpenzime për investime në vlerën 4,000 mijë lekë

000/lekë					
Shp për paga	Shp për sigurime shoqërore dhe shëndet	Shp operative	Transferta tek individët	Investime	Totali
600	601	602	606	231	
620	110	100	800	4,000	5,630

Fondi i planifikuar për paga është në vlerën 620 mijë lekë, për 1 punonjës pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2020.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është në vlerën 110 mijë lekë.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative për këtë projekt është në vlerën 100 mijë lekë

Fondi i planifikuar për transfertat tek individët për këtë program është 800 mijë lekë për të mundësuar trajtimin e rreth 20 familjeve me bonus strehimi.

Fondi I planifikuar për investime në këtë program shkon në vlerën 4,000 mijë lekë. Ky fond parashikohet



BASHKIA KORÇË

të jetë pjesë e bashkëfinancimit me MFE për projektin e Përmirësimit të Kushteve të Banimit të komuniteteve më të pafavorizuara, duke përfshirë dhe pakicat rome dhe egjiptiane.

Totali i shpenzimeve për paga për vitin 2021, për të gjitha programet që menaxhohen nga Bashkia dhe të detajuara si më sipër është 173,888 mijë lekësh ku është përfshirë dhe fondi i vecantë në vlerën 595 mijë lekë dhe krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 16,559 mijë lekësh ose në masën 10.5%.

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore është 29.031 mijë lekësh dhe krahasuar me vitin 2020 ka një rritje prej 2,508 mijë lekësh ose në masën 9.4%.

Fondi i planifikuar për shpenzime operative dhe shërbime publike është 176,041 mijë lekësh dhe krahasuar me planin e rishikuar të vitit 2020 ka një ulje prej 5,013 mijë lekësh ose në masën 3%.

Detajimi i shpenzimeve operative përmbledhëse dhe krahasuese me vitin 2020 jepet si më poshtë:

Përshkrimi i shpenzimeve operative	PI 2020	PI 2020 I rish	Fakt 10m	PI I real te pritsh	PI 2021	Diferenca PI 2021-PI rish	Diferenca PI 2021-PI r prit
Shërbime postare (tel)	1,700,000	1,838,000	1,269,156	1,838,000	1,700,000	-138,000	-138,000
Abonim internet ADSL dhe Central Telefonik	500,000	480,000	396,340	480,000	500,000	20,000	20,000
Energjia elektrike Bashki	9,555,100	6,495,243	3,775,675	5,946,673	7,959,720	1,464,477	2,013,047
